

PARA NJË GJYKATËSI TË TRIBUNALIT

Para: Gjykatësit Richard May

Sekretari : Z. Hans Holthuis

Vendim : i 22 nëntorit 2001

PROKURORJA

kundër

SLLOBODAN MILLOSHEVIQIT

VENDIM MBI RISHOYRTIMIN E AKTAKUZËS

Zyra e Prokurorit:

Zonjë Carla Del Ponte, Prokurore

1. Më datë 12 nëntor 2001, Prokurorja paraqiti një aktakuzë e cila m'u dorëzua mua për rishqyrtim si Gjykatës i një Dhome Gjyqi, sipas Nenit 19 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar dhe Rregullës 47 të Rregullores së Procedurës dhe Provave.
2. Neni 19 kërkon që një Gjykatës të cilit i dorëzohet një aktakuzë, t'a rishqyrtojë atë dhe, nëse "ai bindet që Prokurori ka konstatuar një argument *prima facie*", ta konfirmojë aktakuzën; dhe, nëse nuk bindet, ta refuzojë atë. Rregulla 47 kërkon që Gjykatësi të shqyrtojë secilën nga pikat në aktakuzë si dhe çdo material mbështetës që mund të sigurojë Prokurori, për të përcaktuar, duke zbatuar kriterin e Nenit 19, nëse kundër të dyshuarit ekziston një argument. Pra, qëllimi është që të përcaktohet nëse egziston një argument i përshtatshëm që përlligj fillimin e procedurave kundër të akuzuarit në aktakuzë dhe që siguron se ka baza në mbështetje të pretendimeve që përfshin ajo, duke parandaluar në këtë mënyrë fillimin e procedurave pa baza. Kryerja e kësaj detyre mund të krahasohet me detyrën e një jurie të madhe apo një gjykatësi të betuar sipas "të drejtës zakonore" apo një *juge d'instruction* sipas disa sistemeve të së drejtës civile.¹
3. Aktakuza e ngarkon Sllobodan Millosheviqin në 29 pika me:
 - (a) Gjenocid dhe bashkëfajësi në gjenocid, sipas Nenit 4 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar;
 - (b) Krime kundër njerëzimit duke përfshirë persekutimin, shfarosjen, vrasjen, burgosjen, torturimin, dëbimin dhe veprime çnjerëzore (zhvendosje e detyruar), sipas Nenit 5 të Statutit;
 - (c) Shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës të vitit 1949 që kanë të bëjnë me vrasje të qëllimshme, heqje të paligjshme të lirisë, torturë, shkaktim të qëllimshëm të vuajtjeve të mëdha, dëbim apo zhvendosje të paligjshme, dhe shkatërrimin e gjerë dhe përvetësimin të pronave, sipas Nenit 2 të Statutit;
 - (d) Shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës duke përfshirë, *inter alia*, sulme mbi civilë, shkatërrime të paligjshme, grabitje të pronave, dhe trajtim mizor, sipas Nenit 3 të Statutit;
4. Shkurt, në formë përmbledhjeje, akuzat janë si më poshtë. Aktakuza ka të bëjë me ngjarje të cilat kanë ndodhur në Bosnje dhe Hercegovinë midis viteve 1992 dhe 1995. Argumenti që ngre Prokuroria është që ky i akuzuar, bashkë me të tjerë, ka marrë pjesë në një projekt të përbashkët kriminal, qëllimi i të cilit ishte "zhvendosja e dhunshme dhe përfundimtare e shumicës së popullsisë joserbe, kryesisht myslimanë të Bosnjës dhe kroatë të Bosnjës, nga zonat e mëdha në Republikën e Bosnje dhe Hercegovinës."² Pretendohet se ky projekt kriminal është realizuar nëpërmjet kryerjes së krimeve të shumta gjatë një sërë ofensivash kundër popullatës joserbe.

¹ *Prokurorja kundër Kordiqit et al*, Çështja IT-95-14-I, Vendimi mbi Rishqyrtimin e Aktakuzës, 10 nëntor 1995 (Gjykatësja Gabrielle Kirk McDonald), fq. 3; *Prokurorja kundër Millosheviqit et al*, Çështja IT-99-37-I, Vendimi mbi Rishqyrtimin e Aktakuzës dhe Kërkesa për Urdhëra të Mëtejshëm, 24 maj 1999 (Gjykatësi David Hunt), paragrafi 2.

² *Prokurorja kundër Millosheviqit et al*, Lënda IT-01-51-I, Aktakuza, 22 nëntor 2001, paragrafi 6.

5. Pretendohet se këto ofensiva janë kryer nga 'forcat serbe' në formën e sulmeve mbi qytete dhe fshatra në mbi 40 komuna në Bosnje dhe Hercegovinë të cilat u pushtuan nga këto forca. Më tej pretendohet se, gjatë këtyre sulmeve, u vranë mijëra myslimanë të Bosnjës dhe serbë të Bosnjës (duke përfshirë mijëra vetë të ekzekutuar pas rënies së Srebrenicës). Mijëra të tjerë u burgosën në mbi 50 objekte paraburgimi si kampe, kazerma, stacione policie dhe shkolla; ndërkohë që gjatë qëndrimit atje ata iu nënshtruan kushteve çnjerëzore të jetesës dhe punës së detyruar; shumë prej tyre u vranë dhe të tjerë iu nënshtruan torturave, rrahjeve dhe abuzimit seksual. Nga ata që nuk u burgosën, mijëra u zhvendosën me forcë dhe u dëbuan nga shtëpitë e tyre: numri plotë i atyre që u dëbuan apo u burgosën pretendohet të ketë qenë mbi çerek milioni njerëz.
6. Më tej pretendohet se gjatë pushtimeve dhe pas tyre ka pasur vjedhje dhe grabitje të pronave publike apo private që i përkisnin popullatës joserbe dhe që pushtimet janë shoqëruar me shkatërrimin e papërligjur të shtëpive, institucioneve fetare dhe monumenteve historike. Në mënyrë të veçantë, pretendohet se një pjesë e forcave serbe ka kryer një fushatë të tejzgjatur bombardimesh dhe qitjesh me snajperë kundër civilëve në Sarajevë midis prillit 1992 dhe nëntorit 1995 duke përfshirë 26 raste bombardimi dhe 47 raste qitjesh me snajperë të përmendura në aktakuzë.
7. Në aktakuzë thuhet se i akuzuari mban përgjegjësi penale për krimet e lartpërmendura, së pari, mbi bazën e përgjegjësisë së tij penale individuale sipas Nenit 7(1) të Statutit. Në lidhje me këtë pretendohet se ai ka planifikuar, ka nxitur, ka kryer apo ka ndihmuar në kryerjen e krimeve të ndryshme. Nuk pretendohet se ai i ka kryer krimet fizikisht si person, por ai ka marrë pjesë në projektin e përbashkët kriminal, duke punuar me të tjerë apo nëpërmjet të tjerëve për të arritur synimin e projektit, i cili përfshinte kryerjen e krimeve.
8. Pretendohet që pjesëmarrësit e tjerë në projektin kriminal përfshinin anëtarë të udhëheqjes politike dhe ushtarake të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (RSFJ), më vonë Republika Federale e Jugosllavisë (RFJ), Serbisë dhe *Republika Srpska-s* (RS); anëtarë të lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë (MPB), Armata Popullore Jugosllave (APJ) dhe Ushtria Jugosllave (UJ), bashkë me komandantë të njësive të ndryshme policore dhe paramilitare.
9. Pretendohet se, si figura politike dominuese në Serbi, RSFJ dhe RFJ, i akuzuari ka ushtruar kontroll apo ndikim faktik mbi pjesëmarrësit në projektin e përbashkët kriminal dhe se ka marrë pjesë edhe vetë në të; dhe këtë ai e bëri, *inter alia*, duke kontrolluar, drejtuar apo mbështetur njësitë e APJ-së, VJ, Ushtrisë së Serbëve të Bosnjës (USB), MPB-së dhe paramilitarëve serbë që zbatonin synimet e MPB-së; duke e ndihmuar udhëheqjen e RS-së në pushtimet e komunave dhe duke marrë pjesë në planifikimin e këtyre të fundit; si dhe duke manipuluar dhe kontrolluar mjetet shtetërore serbe të informimit në mënyrë që të transmetonin lajme të rreme, të cilat kishin për qëllim të krijonin një atmosferë frike dhe urrejtjeje.
10. Gjithashtu, pretendohet se i akuzuari, si person në pozitë të lartë drejtuese, në bazë të Nenit 7(3) të Statutit, është përgjegjës për pjesëmarrjen e APJ-së, UJ-së

dhe njësisive të tjera në krimet e pretenduara në aktakuzë. Në mënyrë të veçantë, thuhet se ai ka ushtruar kontroll në mënyrat e mëposhtme:

- (a) nga marsi 1991 deri në qershor 1991, i akuzuari ka kontrolluar efektivisht 'Bllokun Serb' brenda Kryesisë së RFSJ-së (e cila ushtronte pushtetin e Kryesisë duke përfshirë edhe atë të Kryekomandantit kolektiv të APJ-së);
- (b) nga prilli 1992, Këshilli i Lartë i Mbrojtjes (në të cilin i akuzuari ishte anëtar dhe mbi të cilin ai kishte kontroll dhe autoritet të gjerë) ka pasur kontroll *de jure* mbi APJ-në dhe UJ-në;
- (c) gjithashtu, i akuzuari ka pasur kontroll *de facto* mbi agjentët e MPB-së serbe dhe Sigurimit Shtetëror, i cili drejtoi dhe mbështeti veprimet e forcave speciale dhe paramilitarëve serbë në Bosnje dhe Hercegovinë.

11. Sa u tha më lart është një përmbledhje e krimeve të pretenduara në aktakuzë dhe e mënyrës nëpërmjet së cilës pretendohet se i akuzuari ka pasur lidhje me to; dhe, pas rishqyrtimit të aktakuzës, më duhet të përcaktoj nëse Prokurorja ka konstatuar një argument *prima facie*. Siç është vërejtur, Neni 19 i Statutit kërkon që Gjykatësi rishqyrtues të bindet që Prokurorja ka konstatuar një argument *prima facie*, përpara se ta konfirmojë atë. Kriteri i përcaktimit të një argumenti *prima facie* ka qenë temë e trajtuar në vendimet e Gjykatësve shqyrtues të Tribunalit Ndërkombëtar. Për shembull, në rastin kryesor të kësaj teme në vitin 1995, gjatë shqyrtimit të aktakuzës në rastin *Kordiq et al.*,³ Gjykatësja Kirk McDonald zbatoi kriterin e formuluar nga Këshilli Ndërkombëtar i së Drejtës në Projekt-Statutin e tij për një Gjykatë Penale Ndërkombëtare:

“një argument *prima facie* për këtë qëllim vlerësohet të jetë një argument i besueshëm, i cili (nëse nuk kundërshtohet nga Mbrojtja) do të përbënte një bazë të mjaftueshme për ta dënuar të akuzuarin për akuzën e ngritur.”⁴

12. Ky kriter u ndoq nga Gjykatësi Hunt në vitin 1999 gjatë rishqyrtimit të aktakuzës në çështjen *Milloseviq et al.*,⁵ edhe pse i formuluar paksa ndryshe, në thelb ishte se një argument i vërtetë *prima facie* egziston atëherë “kur provat materiale të sjella në aktakuzë përbëjnë një argument të besueshëm [...]”⁶
13. Gjatë marrjes së vendimit lidhur me lejimin apo jo të Prokurores për bërjen e disa ndryshimeve në të njëjtën aktakuzë në vitin 2001, Gjykatësi Hunt tha se ishin kryer hetime lidhur me elementet përbërëse të një argumenti *prima facie*, meqenëse vendimi dhe përkufizimi i mëparshëm tani ishte i shprehur ndryshe, d.m.th. nëse ka prova (nëse pranohen) mbi të cilat një gjykatë e arsyeshme fakti mund të bindej përtej çdo dyshimi të logjikshëm mbi fajësinë e të

³ Prokurorja kundër *Kordiqit et al.*, Çështja IT-95-14-I, Vendimi mbi Shqyrtimin e Aktakuzës, 10 nëntor 1995.

⁴ *Kordiq*, fq 2-3. *Shih* Raporti i Këshillit Ndërkombëtar të së Drejtës në punimet e sesionit të tij të 46-të, U.N. GAOR, Sesioni i 49-të, U.N. Doc. A/49/10(1994).

⁵ Prokurorja kundër *Milloseviqit et al.*, Çështja IT_99-37-I, Vendimi mbi Shqyrtimin e Aktakuzës dhe Kërkesa për Urdhëra të Mëtejshëm, 24 maj 1999.

⁶ *Milloseviq*, paragrafi 4 (shënimi në fund të faqes është hequr).

akuzuarit lidhur me një pikë të caktuar të akuzës.⁷ Megjithatë, ky formulim bazohet mbi kriterin që duhet të zbatohet në përcaktimin e një propozimi sipas Rregullës 98 *bis* për dhënien e gjykimit të pafajësisë (shkarkim nga akuza) pas përfundimit të argumentit të Prokurorisë, një fazë e mëvonshme e procedurave në krahasim me shqyrtimin e tanishëm. Nga ana tjetër, Gjykatësi Hunt gjithashtu tha se thelbi i kriterit ishte i njëjtë;⁸ dhe, në fakt, të dy formulimet përmbajnë konceptin themelor që Prokurorja duhet të sigurojë prova të mjaftueshme, të cilat, nëse pranohen, do të ishin të mjaftueshme për dënimin e të akuzuarit.

14. Për këtë arsye, për rishqyrtim unë do të zbatoj kriterin e formuluar nga Gjykatësja Kirk McDonald si më i përshtatshëm për këtë fazë të procedurave. Zbatimin e kriterit do ta kushtëzoja me këtë vërejtje; argumenti duhet të jetë i tillë që të bazohet në prova, të cilat, nëse pranohen nga një Dhomë Gjyqi, do të përbënin bazë të mjaftueshme për dënim. Prandaj, do të ishte më e përshtatshme që një argument *prima facie* të shihet si një argument i besueshëm, i cili, nëse pranohet dhe nuk kundërshtohet, do të përbënte bazë të mjaftueshme mbi të cilën të dënohet i akuzuari. I takon Dhomës së Gjyqit të vendosë lidhur me pranimin ose jo të fakteve të sjellë në aktakuzë: kjo nuk është detyra e Gjykatësit shqyrtues.
15. Gjatë shqyrtimit të kësaj aktakuze, kam analizuar çdo pikë dhe kam marrë parasysh materialet mbështetëse të siguruar nga Prokurorja. Kam dëgjuar avokatin e Prokurorisë. I kam kërkuar Prokurores të paraqesë materiale plotësuese dhe gjithashtu kam pezulluar rishqyrtimin për t'i dhënë asaj mundësinë për të ndryshuar pjesërisht aktakuzën. Zbatoj kriterin e paraparë në Nenin 19, siç është shpjeguar më lart. Tani jam i bindur që Prokurorja ka konstatuar një argument *prima facie* në secilën pikë dhe që ka materiale për ti mbështetur ato. Janë përmbushur edhe kriteret e Nenit 19, edhe ato të Rregullës 47.
16. Për arsyet e lartpërmendura,

UNË KONFIRMOJ të gjitha pikat në aktakuzën e paraqitur nga Prokurorja.

Dhe URDHËROJ, më tej, që aktakuza me shënime që i është bashkangjitur paraqitjes së Prokurores të mos konsiderohet pjesë e materialeve mbështetëse me qëllim që t'i paraqitet të akuzuarit.

E bërë në anglisht dhe frëngjisht, ku teksti në anglisht ka përparësi.

Datë 22 nëntor 2001

Në Hagë

Hollandë

Richard May
Gjykatës
Tribunali Ndërkombëtar

⁷ *Prokurorja kundër Millosheviqit et al*, Çështja IT-99-37-I, Vendimi mbi Ndryshimin e Aktakuzës dhe mbi Konfirmimin e Aktakuzës së Ndryshuar, 29 qershor 2001, paragrafi 3.

⁸ *Ibid.*

TRIBUNALI NDËRKOMBËTAR PENAL PËR ISH-JUGOSLLAVINË

LËNDA Nr. IT-01-51-I

**PROKURORJA
E TRIBUNALIT**

KUNDËR

SLLOBODAN MILLOSHEVIQIT

AKTAKUZË

Prokurorja e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, në bazë të autoritetit të saj sipas Nenit 18 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (“Statuti i Tribunalit”), ngarkon :

SLLOBODAN MILLOSHEVIQIN

me **GJENOCID, KRIME KUNDËR NJERËZIMIT, SHKELJE TË RËNDA TË KONVENTAVE TË GJENEVËS** dhe **SHKELJE TË LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS** siç përshkruhet më poshtë:

I AKUZUARI

1. **Sllobodan MILLOSHEVIQ**, biri i Svetozar Millosheviqit, i lindur më 20 gusht 1941 në Pozharevc, në Republikën aktuale të Serbisë, një nga republikat përbërëse të Republikës Federale të Jugosllavisë (“RFJ”). Në vitin 1964, ai u diplomua në Fakultetin Juridik të Universitetit të Beogradit dhe filloi karrierë si drejtues dhe bankier. Deri në vitin 1978, ai mbajti postin e zëvendësdrejtorit dhe më vonë atë të drejtorit të përgjithshëm të *Tehnogas*, një kompani e madhe e gazit në Republikën Socialiste Federale të Jugosllavisë të atëhershme (“RSFJ”). Pas kësaj, ai u bë kryetar i *Beogradska Banka (Beobanka)*, një nga bankat më të mëdha në RSFJ, post në të cilin ai qëndroi deri në vitin 1983.

2. **Sllobodan MILLOSHEVIQI** iu bashkua Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë në vitin 1959. Në vitin 1984, ai u bë Kryetar i Komitetit të Lidhjes së Komunistëve për Qytetin e Beogradit. Në vitin 1986, ai u zgjodh Kryetar i Kryesisë të Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë dhe u rizgjodh në vitin 1988. Më 16 korrik 1990, Lidhja e Komunistëve të Serbisë dhe Aleanca Socialiste e Popullit Punonjës të Serbisë u bashkuan duke formuar një parti të quajtur Partia Socialiste e Serbisë (“PSS”). Më 17 korrik 1990, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** u zgjodh kryetar i

PSS-së dhe mbeti në atë post me përjashtim të periudhës nga 24 maji 1991 deri më 24 tetor 1992.

3. **Sllobodan MILLOSHEVIQI** u zgjodh Kryetar i Kryesisë së Republikës së atëhershme Socialiste të Serbisë më 8 maj 1989 dhe u rizgjodh më 5 dhjetor 1989. Pas miratimit të Kushtetutës së re më 28 shtator 1990, Republika Socialiste e Serbisë u bë Republika e Serbisë, dhe **Sllobodan MILLOSHEVIQI** u zgjodh në postin e sapokrijuar të Kryetarit të Republikës së Serbisë në zgjedhjet shumëpartiake të mbajtura në dhjetor 1990. Ai u rizgjodh në këtë post në zgjedhjet e mbajtura më 20 dhjetor 1992.

4. Pas dy mandateve si Kryetar i Republikës së Serbisë, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** u zgjodh Kryetar i Republikës Federale të Jugosllavisë më 15 korrik 1997 dhe detyrën zyrtare e filloi më 23 korrik 1997. Pas humbjes së tij në zgjedhjet presidenciale të Republikës Federale të Jugosllavisë në shtator 2000, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** u largua nga posti i tij më 6 tetor 2000.

PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE

Neni 7(1) i Statutit të Tribunalit

5. **Sllobodan MILLOSHEVIQI** mban përgjegjësi penale individuale për krimet e përmendur në Nenet 2, 3, 4 dhe 5 të Statutit të Tribunalit dhe të përshkruar në këtë aktakuzë, të cilat ai i planifikoi, nxiti, urdhëroi, kreu, ose përndryshe ndihmoi në planifikimin, përgatitjen apo kryerjen e tyre. Me anë të përdorimit të fjalës “kreu” në këtë aktakuzë, Prokurorja nuk synon të sugjerojë se i akuzuari kreu fizikisht ndonjë nga krimet për të cilat ai ngarkohet. “Kreu” në këtë aktakuzë do të thotë pjesëmarrje si bashkëkryes në një projekt të përbashkët kriminal.

6. **Sllobodan MILLOSHEVIQI** mori pjesë në projektin e përbashkët kriminal siç përshkruhet më poshtë. Qëllimi i këtij projekti të përbashkët kriminal ishte zhvendosja e dhunshme dhe përfundimtare e shumicës së popullsisë joserbe, kryesisht myslimanë të Bosnjës dhe kroatë të Bosnjës, nga zona të mëdha të Republikës së Bosnje dhe Hercegovinës (këtu e më tej “Bosnja dhe Hercegovina”), nëpërmjet kryerjes së krimeve të cilat janë shkelje të Neneve 2, 3, 4 dhe 5 të Statutit të Tribunalit.

7. Projekti i përbashkët kriminal filloi para 1 gushtin 1991 dhe vazhdoi të paktën deri më 31 dhjetor 1995. Midis individëve që morën pjesë në këtë projekt të përbashkët kriminal përfshihen **Sllobodan MILLOSHEVIQI**, Radon KARAGJIQ, Momçillo KRAJISHNIK, Biljana PLAVSHIQ, Gjenerali Ratko MLLADIQ, Borislav JOVIQ, Branko KOSTIQ, Velko KADIJEVIQ, Bllagoje AXHIQ, Milan MARTIQ, Jovica STANISHIQ, Franko SIMATOVIQ, i njohur edhe me nofkën “Frenki”, Radon STOJIÇIQ, i njohur edhe me nofkën “Baxha”, Vojisllav SHESHELI, Zhelko RAZHNJATOVIQI, i njohur edhe me nofkën “Arkani”, si dhe pjesëmarrës të tjerë të njohur dhe të panjohur.

8. Krimet e renditur në Pikat 1 deri në 29 të kësaj aktakuze ishin pjesë e synimit të projektit të përbashkët kriminal. Nga ana tjetër, krimet e renditur në Pikat 1 deri në 15 dhe 19 deri në 29 ishin pasojat e natyrshme dhe të parashikueshme të konkretizimit të synimit të projektit të përbashkët kriminal dhe i akuzuari ishte i vetëdijshëm për faktin

se këto krime ishin rezultate të mundshëm të zbatimit të projektit të përbashkët kriminal.

9. Për të përmbushur synimin e projektit të përbashkët kriminal, **Slobodan MILLOSHEVIQI** veproi në bashkëpunim ose nëpërmjet disa individë në projektin e përbashkët kriminal. Çdo pjesëmarrësit apo bashkëkryes në projektin e përbashkët kriminal, me qëllimin e përbashkët për të kontribuar në projekt, kreu rolin apo rolet që kontribuan dukshëm në synimin e përgjithshëm të projektit. Rolet e pjesëmarrësve apo bashkëkryesve përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm me këto:

10. Radovan KARAGJIIQI ka qenë Kryetar i Partisë Demokratike të Bosnje dhe Hercegovinës (*Srpska demokratska stranka Bosne i Hercegovine*, apo “SDS”) gjatë periudhës që përfshin aktakuza. Më 27 mars 1992, KARAGJIIQI u bë Kryetari i “Këshillit Kombëtar të Sigurimit” të serbëve të Bosnjës. Më 12 maj 1992, ai u zgjodh Kryetar i Kryesisë prej tre anëtarësh të Republikës së vetëshpallur Serbe të Bosnje dhe Hercegovinës (këtu e më tej “Republika Srpska”) dhe mbeti në këtë post pas zgjerimit të Kryesisë me pesë anëtarë më 2 qershor 1992. Më 17 dhjetor 1992, KARAGJIIQI u zgjodh Kryetar i Republika Srpska-s, post në të cilin ai qëndroi gjatë gjithë kohës që përfshin aktakuza. Në cilësinë e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Sigurimit të serbëve të Bosnjës, anëtarit të Kryesisë, si Kryetar i Republika Srpska-s dhe postit të tij udhëheqës brenda partisë së SDS-së dhe organeve të qeverisë së Republika Srpska-s, Radovan KARAGJIIQI, së bashku me të tjerë, komandoi, drejtoi ose përndryshe ushtroi kontroll faktik mbi Mbrojtjen Territoriale (“MT”), ushtrinë e serbëve të Bosnjës (“USB”) dhe forcat policore të Republika Srpska’s, të cilat morën pjesë në krimet e përcaktuar në këtë aktakuzë.

11. Momçillo KRAJISHNIK, bashkëpunëtor i ngushtë i Radovan KARAXHIQIT, ka qenë anëtar i Kryesisë të SDS-së nga 12 korriku 1992. Më 24 tetor 1991, ditën e themelimit të “Kuvendit të Serbëve të Bosnje dhe Hercegovinës” (këtu e më tej “Kuvendi i Serbëve të Bosnjës”) KRAJISHNIK u zgjodh Kryetar i tij. Nga 27 marsi 1992, KRAJISHNIK ishte anëtar i Këshillit Kombëtar të Sigurimit të Serbëve të Bosnjës. Ai u bë anëtar i Kryesisë prej pesë anëtarësh më 2 qershor 1992. Kur Kuvendi i Serbëve të Bosnjës zgjodhi Radovan KARAXHIQIN Kryetar të Republika Srpska-s më 17 dhjetor 1992, KRAJISHNIK pushoi së qeni anëtar i Kryesisë, por vazhdoi të ishte një nga udhëheqësit politikë më të rëndësishëm të Republika Srpska-s dhe mbeti Kryetar i Kuvendit të saj Kombëtar deri më 19 tetor 1996. Në cilësinë e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Sigurimit të Serbëve të Bosnjës si anëtar i Kryesisë së Republika Srpska-s dhe në postin e tij të udhëheqës brenda partisë së SDS-së dhe organeve të qeverisë së Republika Srpska-s, Momçillo KRAJISHNIK, bashkë me të tjerë, komandoi, drejtoi ose përndryshe ushtroi kontroll faktik mbi MB-në, USB-në dhe forcat policore të Republika Srpska-s të cilat morën pjesë në krimet e përcaktuar në këtë aktakuzë.

12. Biljana PLAVSHIQ, politikane e SDS-së në rang të lartë, më 28 shkurt 1992 u bë një nga dy personat në rolin e Kryetarit të Përkohshëm të Republikës Serbe të Bosnje dhe Hercegovinës, bashkë me Nikolla KOLJEVIQ. Në rolin e Kryetares së Përkohshme, Biljana PLAVSHIQ u bë anëtare *ex officio* e Këshillit Kombëtar të Sigurimit të Serbëve të Bosnjës. Më 12 maj 1992, ajo u zgjodh si anëtare e Kryesisë prej tre anëtarësh dhe mbeti në këtë post edhe pas zgjerimit të kryesisë me pesë anëtarë. Kur Kuvendi i Serbëve të Bosnjës zgjodhi Radovan KARAXHIQIN Kryetar

të Republika Srpska-s më 17 dhjetor 1992, ajo gjithashtu zgjodhi Biljana PLAVSHIQIN njëren nga dy Zv/Kryetarët, një post që ajo e mbajti deri më 19 korrik 1996. Në cilësinë e Zv/Kryetares, anëtares së Këshillit Kombëtar të Sigurimit të Serbëve të Bosnjës si anëtare e Kryesisë së Republika Srpska-s, dhe në postin e saj të udhëheqjes brenda partisë së SDS-së dhe organeve të qeverisë së Republika Srpska-s, Biljana PLAVSHIQ, bashkë me të tjerë, komandoi, drejtoi, ose përndryshe ushtroi kontroll faktit mbi MB-në, USB-në dhe forcat policore të Republika Srpska-s të cilat morën pjesë në krimet e përcaktuar në këtë aktakuzë.

13. Gjenerali Ratko MLLADIQ, oficer karriere, që kishte shërbyer më parë në Maqedoni dhe Kosovë, u bë komandanti i Korpusit të 9^{-të} (Korpusi i Kninit) të Armatës Popullore Jugosllave (“APJ”) në qershor 1991 dhe mori pjesë në luftimet në Kroaci. Më 4 tetor 1991, Kryesia e RSFJ-së e gradoi Gjeneral Major. Në vijim, në maj 1992, ai mori përsipër komandën e forcave të Zonës së Dytë Ushtarake të APJ-së në Sarajevë. Nga 12 maji 1992 deri në nëntor 1996, ai ishte Komandant i Shtabit Qendror të USB-së dhe në këtë cilësi ai, bashkë me të tjerë, komandoi, drejtoi, ose përndryshe ushtroi kontroll faktik mbi USB-në dhe njësitë e tjera që vepronin në bashkërendim me USB-në të cilat morën pjesë në krimet e përcaktuar në këtë aktakuzë.

14. Borisav JOVIQI ishte në vijim Zv/Kryetar, Kryetar dhe më pas anëtar i Kryesisë së RSFJ-së nga 15 maji 1989 deri në prill 1992, si dhe Kryetar i PSS-së (Partia Socialiste e Serbisë) nga maji 1991 deri në tetor 1992, dhe zyrtar i rangut të lartë në PSS-së deri në nëntor 1995. Borisav JOVIQI dhe Branko KOSTIQI, Zv/Kryetari dhe në atë kohë Kryetar i Përkohshëm i Kryesisë së RSFJ-së, bashkë me të tjerë gjatë periudhës që lidhet me aktakuzën, komanduan, drejtuan, ose përndryshe ushtroan kontroll faktik mbi APJ-në dhe anëtarët e MT-së si dhe njësitë paramilitare që vepronin në bashkërendim me AJP-në dhe nën mbikqyrjen e saj.

15. Gjeneral Velko KADIJEVIQ, si Sekretar Federal për Mbrojtjen Kombëtare nga 15 maji 1988 deri më 6 janar 1992, komandoi, drejtoi ose përndryshe ushtroi kontroll faktik mbi APJ-në dhe njësi të tjera që vepronin në bashkërendim me APJ-në.

16. Gjeneral Bllagoje AXHIQ, në cilësinë e Shefit të Shtabit të APJ-së nga viti 1990 deri më 28 shkurt 1992 dhe në rolin e Sekretarit Federal të Përkohshëm për Mbrojtjen Kombëtare nga mesi i vitit 1991 deri më 28 shkurt 1992, Sekretar Federal për Mbrojtjen Kombëtare nga 28 shkurti 1992 deri më 27 prill 1992 dhe Shef i Shtabit të APJ-së nga 27 prilli 1992 deri më 8 maj 1992, bashkë me të tjerë, komandoi, drejtoi ose përndryshe ushtroi kontroll faktik mbi APJ-në dhe njësi të tjera që vepronin në bashkërendim me APJ-në.

17. Jovica STANISHIQ, në cilësinë e Shefit të Sigurimit Shtetëror (*Državna bezbednost* apo “DB”) të Republikës së Serbisë nga marsi 1991 deri në tetor 1998, komandoi, drejtoi ose përndryshe ushtroi kontroll faktik mbi anëtarët e DB-së, të cilët morën pjesë në kryerjen e krimeve të përcaktuar në këtë aktakuzë. Për më tepër ai u siguroi armë, mjete financiare, stërvitje dhe ndihmë tjetër të konsiderueshme ose mbështetje njësive paramilitare serbe dhe njësive policore të cilat më pas u përfshinë në kryerjen e krimeve të përcaktuar në këtë aktakuzë.

18. Franko SIMATOVIQI, gjithashtu i njohur edhe me nofkën “Frenki”, si shef i seksionit për operacione speciale të DB-në e Republikës së Serbisë, komandoi, drejtoi

ose përndryshe ushtroi kontroll faktik mbi agjentët e DB-së të cilët kryen krimet e përcaktuar në këtë aktakuzë. Për më tepër a u siguroi armë, mjete financiare, stërvitje apo ndihmë tjetër të konsiderueshme ose mbështetje njësive paramilitare serbe dhe njësive policore të cilat më pas u përfshinë në krimet e akuzuara në këtë aktakuzë.

19. Radovan STOJIČIQ, gjithashtu i njohur edhe me nofkën “Baxha”, si Zv/Ministër i Brendshëm i Serbisë dhe Shef i Shërbimit Publik të Sigurimit, komandoi, drejtoi ose përndryshe ushtroi kontroll faktik mbi forcat speciale të MPB-së serbe dhe njësi vullnetare të cilat morën pjesë në krimet e përcaktuara në këtë aktakuzë. Për më tepër, ai u siguroi armë, mjete financiare, stërvitje apo ndihmë tjetër të konsiderueshme ose mbështetje njësive paramilitare dhe njësive policore të cilat më pas u përfshinë në krimet e përcaktuara në këtë aktakuzë.

20. Millan MARTIQI, si “Sekretar i Sekretariatit të Punëve të Brendshme” i të ashtuquajturit Krajinës Autonome Serbe (SAO) të Krajinës prej 4 janarit 1991 deri më 29 maj 1991; si “Ministër i Mbrojtjes” i SAO të Krajinës prej 29 majit 1991 deri më 27 qershor 1991; dhe si “Ministër i Punëve të Brendshme” i SAO të Krajinës (më vonë Republika e Krajinës Serbe) prej 27 qershorit 1991 deri në janar 1994, themeloi, komandoi, drejtoi dhe përndryshe ushtroi kontroll faktik mbi anëtarët e forcës policore të tij (e quajtur “Policia e Martiqit”, “Milicia e Martiqit”, *Martićevci*”, “Policia e SAO të Krajinës”, ose Milicia e SAO të Krajinës”), të cilët më pas u përfshinë në krimet e përcaktuar në këtë aktakuzë.

21. Zhelko RAZHNJATOVIQI, i njohur edhe si “Arkani,” në vitin 1990 themeloi dhe komandoi Gardën Vullnetare Serbe, një njësi vullnetare e njohur gjerësisht si “*Arkanovci*” ose “Tigrat e Arkanit”, të cilët gjatë kohës lidhur me këtë aktakuzë vepronin në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe u përfshinë në krimet e akuzuara në këtë aktakuzë. Për më tepër, ai kishte një bazë ushtarake mjaft të madhe në Erdut, në Kroaci, ku ai vepronte si komandant. Grupet paramilitare të tjera dhe njësi të Mbrojtjes Territoriale u stërvitën në këtë bazë dhe më pas u përfshinë në krimet e akuzuara në këtë aktakuzë.

22. Vojislav SHESHELLI, si Kryetar i Partisë Radikale Serbe (SRS) së paku prej shkurtit 1991, gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, rekrutoi ose përndryshe u siguroi ndihmë të konsiderueshme ose përkrahje njësive paramilitare serbe, të njohura gjerësisht si “*Šešeljevci*” ose “njerëzit e Sheshelit”, të cilët kryen krime të përcaktuar në këtë aktakuzë. Për më tepër, ai mbështeti haptazi dhe nxiti krijimin e “Serbisë së Madhe” me dhunë ose mënyrë të tjera të paligjshme dhe mori pjesë aktive në propagandën e luftës dhe përhapjen e urrejtjes ndëretnike.

23. Prej vitit 1987 deri vonë në vitin 2000, **Slobodan MILLOSHEVIQI** ishte personaliteti kryesor politik në Serbi dhe në RSFJ/RFJ. Ai mori kontroll mbi të gjitha aspektet e qeverisë serbe, duke përfshirë policinë dhe shërbimet e sigurimit shtetëror. Për më tepër, ai siguroi kontroll mbi udhëheqësit politikë të Kosovës, Vojvodinës dhe Malit të Zi.

24. Në cilësinë e Kryetarit të Serbisë dhe falë pozitës së tij udhëheqëse në SPS-në, **Slobodan MILLOSHEVIQI** ushtroi kontroll faktik apo ndikim të konsiderueshëm mbi pjesëmarrësit e lartpërmendur në projektin e përbashkët kriminal dhe qoftë vetëm qoftë bashkë me ta dhe me persona të tjerë të njohur dhe të panjohur, mbajti kontroll

faktik ose ndikoi në mënyrë të konsiderueshme veprimet e Kryesisë Federale të RSFJ-së dhe më vonë të RFJ-së; veprimet e Ministrisë Serbe të Punëve të Brendshme (“MPB”); të APJ-së, të Ushtrisë Jugosllave (“UJ”) dhe të Ushtrisë së Republikës Serbe, si edhe të grupeve paramilitare serbe.

25. **Slobodan MILLOSHEVIQI**, duke vepruar vetëm dhe bashkë me anëtarët e tjerë të projektit kriminal të përbashkët, mori pjesë në projektin e përbashkët kriminal në këto mënyra:

- a) ai ushtroi kontroll faktik mbi elementet e APJ-së dhe të UJ-së të cilat morën pjesë në planifikimin, përgatitjen, lehtësimin dhe zbatimin e largimit me dhunë të shumicës së joserbëve, kryesisht myslimanë të Bosnjës dhe kroatë të Bosnjës, prej shumë viseve të Bosnjës dhe Hercegovinës.
- b) Ai i siguroi USB-së përkrahje financiare, logjistike dhe politike. Këto forca më pas morën pjesë në realizimin e projektit të përbashkët kriminal përmes kryerjes së krimeve që janë shkelje të Neneve 2, 3, 4 dhe 5 të Statutit të Tribunalit.
- c) Ai ushtroi ndikim të konsiderueshëm mbi udhëheqësinë politike të Republikës Serbe dhe e ndihmoi atë në planifikimin, përgatitjen, lehtësimin dhe zbatimin të marrjes së pushtetit të komunave në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe të largimit të mëvonshëm me dhunë të shumicës së joserbëve, kryesisht myslimanë të Bosnjës dhe kroatë të Bosnjës, prej këtyre komunave.
- d) Ai mori pjesë në planifikimin dhe përgatitjen e marrjes nën kontroll të komunave në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe të largimit të mëvonshëm me dhunë të shumicës së joserbëve, kryesisht myslimanë të Bosnjës dhe kroatë të Bosnjës, prej këtyre komunave. Ai siguroi përkrahjen financiare, materiale dhe logjistike të nevojshme për këtë marrje të pushtetit.
- e) Ai mori pjesë në formimin, financimin, furnizimin, mbështetjen dhe drejtimin e forcave speciale të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë. Këto forca speciale morën pjesë në realizimin e projektit të përbashkët kriminal përmes kryerjes së krimeve që janë shkelje të Neneve 2, 3, 4 dhe 5 të Statutit të Tribunalit.
- f) Ai mori pjesë në dhënien e drejtimit dhe mbështetjes financiare, logjistike dhe politike forcave të parregullta serbe ose paramilitarëve.
- g) Ai kontrolli, manipuloi ose përndryshë shfrytëzoi mjetet serbe të informimit shtetëror për të përhapur lajme të fryra dhe të të rreme për sulme me bazë etnike nga ana e myslimanëve të Bosnjës dhe kroatëve kundër serbëve, me qëllim që të krijonte një atmosferë frike dhe urrejtjeje midis serbëve që jetonin në Serbi, Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë, gjë që kontribuoi në largimin me dhunë të shumicës së joserbëve, kryesisht myslimanë të Bosnjës dhe kroatë të Bosnjës, prej shumë viseve të Bosnjës e Hercegovinës.

26. **Sllobodan MILLOSHEVIQI** mori pjesë në projektin e përbashkët kriminal në mënyrë të vetëdijëshme dhe të qëllimshme, duke qenë në dijeni të pasojave të parashikueshme të këtij projekti. Mbi këtë bazë, ai mban përgjegjësi penale individuale për këto krime sipas Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit, përpos përgjegjesisë së tij sipas të njëjtit Nen pasi planifikoi, nxiti, urdhëroi ose përndryshe ndihmoi në planifikimin, përgatitjen dhe kryerjen e këtyre krimeve.

Neni 7(3) i Statutit të Tribunalit

27. **Sllobodan MILLOSHEVIQI**, duke mbajtur poste me autoritet epror, gjithashtu mban përgjegjësi penale individuale për veprimet dhe mosveprimet e vartësve të vet, në bazë të Nenit 7(3) të Statutit të Tribunalit. Eprori mban përgjegjësi penale për veprimet kriminale të vartësve të vet në qoftë se ai dinte ose kishte arsye të dinte se vartësit do të kryenin veprime të tilla ose i kishin kryer dhe eprori nuk kishte marrë masat e domosdoshme dhe të arsyeshme për të parandaluar vepra të tilla ose për t'i ndëshkuar kryesit e tyre.

28. Së paku prej marsit 1991 deri në 15 qershor 1992, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** ushtroi kontroll faktik mbi katër anëtarët e “Bllokut Serb” brenda Kryesisë së RSFJ-së. Këta katër individë ishin Borisav JOVIQI, përfaqësues i Republikës së Serbisë; Branko KOSTIQI, përfaqësues i Republikës së Malit të Zi; Jugosllav KOSTIQI, përfaqësuesi i Krahinës Autonome të Vojvodinës; dhe Sejdo BAJRAMOVIQI, përfaqësues i Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë. **Sllobodan MILLOSHEVIQI** përdori Borisav JOVIQIN dhe Branko KOSTIQIN si përfaqësues të tij kryesor në Kryesinë dhe nëpërmjet tyre drejtoi veprimet e “Bllokut serb”. Prej 1 tetorit 1991, në mungesë të përfaqësuesve të Kryesisë nga Kroacia, Sllovenia, Maqedonia dhe Bosnja dhe Hercegovina, të katër anëtarët e “Bllokut serb” ushtruan kompetencat e Kryesisë, duke përfshirë ato të “Kryekomandantit” të APJ-së. Kjo “Kryesi e mbetur” veprroi pa kundërshtim për të zbatuar politikën e **Sllobodan MILLOSHEVIQIT**. Kryesia Federale kishte kontroll faktik mbi APJ-në si “Kryekomandant” i saj edhe mbi njësi të tjera nën mbikëqyrjen e APJ-së. Gjeneralët Velko KADIJEVIQ dhe Bllagoje AXHIQ, të cilët drejtuan dhe mbikëqyrën forcat e APJ-së në Bosnjë dhe Hercegovinë ishin në komunikim dhe këshillim të pandërprerë me të akuzuarin.

29. Më 27 prill 1992, u formua Këshilli Suprem i Mbrojtjes. Gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** ka qenë anëtar i Këshillit Suprem të Mbrojtjes dhe ka ushtruar ndikim dhe kontroll të konsiderueshëm mbi anëtarët e tjerë të Këshillit. Këshilli Suprem i Mbrojtjes dhe Kryetari i RFJ-së kishin kontroll *de jure* mbi APJ-në dhe më vonë mbi UJ-në. Përpos autoritetit *de jure*, gjatë tërë periudhës që lidhet me këtë aktakuzë **Sllobodan MILLOSHEVIQI** ushtroi kontroll *de facto* mbi APJ-në dhe UJ-në nëpërmje kontrollit që ai kishte mbi oficerët e lartë të këtyre ushtrive.

30. Si rrjedhim **Sllobodan MILLOSHEVIQI** mban përgjegjësi penale individuale sipas Nenit 7 (3) të Statutit të Tribunalit për pjesëmarrjen e anëtarëve të APJ-së, të UJ-së dhe të njërive të tjera nën mbikëqyrjen e APJ-së dhe të UJ-së në krimet e përshkruara në këtë aktakuzë.

31. Prej kohës kur **Slobodan MILLOSHEVIQI** erdhi në pushtet në Serbi, ai ushtroi kontroll mbi zyrtarë kyç në MPB-në e Serbisë, ndër të tjerë Radmillo BOGDANOVIQIN dhe Zoran SOKOLOVIQIN, të dy në kohë të ndryshme, ministra të punëve të brendshme të Serbisë. Ai gjithashtu ushtroi kontroll mbi Jovica STANISHIQIN dhe Franko SIMATOVIQIN, të dy zyrtarë të lartë në Sigurimin Shtetëror. Nëpërmjet këtyre zyrtarëve, **Slobodan MILLOSHEVIQI** ushtroi kontroll faktik mbi agjentët e MPB-së dhe të Sigurimit Shtetëror të cilët drejtuan dhe mbështetën veprimet e forcave speciale dhe grupeve paramilitare serbe që vepronin në Bosnjë dhe Hercegovinë. Si rrjedhim i akuzuari **Slobodan MILLOSHEVIQI** mban përgjegjësi penale individuale sipas Nenit 7 (3) të Statutit të Tribunalit për pjesëmarrjen e anëtarëve të MPB-së të Serbisë dhe të Sigurimit Shtetëror në krimet e përshkruara në këtë aktakuzë.

AKUZAT

PIKAT 1 dhe 2 GJENOCID OSE BASHKËFAJËSI NË GJENOCID

32. Prej datës 1 mars 1992 deri më ose rreth 31 dhjetor 1995, **Slobodan MILLOSHEVIQI**, duke vepruar vetëm ose bashkë me anëtarë të tjerë të projektit të përbashkët kriminal, planifikoi, nxiti, urdhëro, kreu ose përndryshe ndihmoi në planifikimin, përgatitjen dhe kryerjen e shkatërrimit të tërësishëm ose të pjesshëm të grupeve kombëtare, etnike, racore ose fetare si ato të të myslimanëve të Bosnjës dhe të Kroatëve të Bosnjës, në viset brenda Bosnjës dhe Hercegovinës, duke përfshirë: Bijelinë; Bosanski Novi; Bosanski Shamac; Bratunac; Bërçkë; Doboj, Foçë; Sarajevë (Ilijash); Kluç; Kotor Varosh; Sarajevë (Novi Grad); Prijedor; Rogaticë; Sanski Most; Srebrenicë; Vishegrad; Vlasenicë dhe Zvornik. Shkatërrimi i këtyre grupeve u krye nëpërmjet:

- a) vrasjes në një shkallë të gjerë të mijërave myslimanëve të Bosnjës dhe Kroatëve të Bosnjës gjatë dhe pas vënies nën kontroll të viseve brenda Bosnjës dhe Hercegovinës, duke përfshirë vendet e lartpërmendura, si të përcaktuara në **Tabelën A**^[KBI] të bashkëngjitur kësaj aktakuze. Në shumë nga këto vise anëtarë të shquar dhe të arsimuar të këtyre grupeve u vunë në shënjestër posaçërisht për tu ekzekutuar, shpeshherë sipas listave të parapërgatitura. Pas rënies së Srebrenicës në korrik 1995, pothuajse të gjithë burrat dhe djemtë myslimanë të Bosnjës, që u kapën, gjithsej disa mijëra, u ekzekutuan në vendet ku u kapën ose në vende në të cilat u transportuan për ekzekutim.
- b) vrasjes së mijërave të myslimanëve të Bosnjës dhe të Kroatëve të Bosnjës në objekte burgimi brenda Bosnjës dhe Hercegovinës, duke përfshirë ata që gjenden brenda viseve të lartpërmendura, të renditur në **Tabelën B** të bashkëngjitur kësaj aktakuze.
- c) shkatërrimit të lëndimit të rëndë trupor dhe psikologjik ndaj mijërave myslimanëve të Bosnjës dhe kroatëve të Bosnjës gjatë burgosjes të tyre në objekte burgimi brenda Bosnjës dhe Hercegovinës, duke përfshirë ata që gjenden brenda viseve të lartpërmendur, të përcaktuar në **Tabelën C** të

bashkëngjitur kësaj aktakuze. Anëtarët e këtyre grupeve, gjatë burgosjes së tyre në objekte burgimi dhe marrjes së tyre në pyetje në këto objekte, stacione të policisë dhe kazerma ushtarake iu nënshtruan vazhdimisht ose u detyruan të shikonin veprime çnjerëzore duke përfshirë vrasje, dhunë seksuale, tortura dhe rrahje.

d) Mbajtjes së mijërave myslimanëve të Bosnjës dhe kroatëve të Bosnjës në objekte burgimi brenda Bosnjës dhe Hercegovinës, duke përfshirë ata në viset e lartpërmendur, në kushte të jetesës që synonin të kryenin shkatërrimin e pjesshëm fizik të këtyre grupeve me anë të urisë, ujit të ndotur, punës së detyruar, kujdesit mjekësor të mangët dhe sulmeve të vazhdueshëm fizikë dhe psikologjikë.

Me këto veprime dhe mosveprime, **Sillobodan MILLOSHEVIQI** kreu:

Pika 1: GJENOCID, i ndëshkueshëm në bazë të Neneve 4 (3)(a), dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit; ose

Pika 2: BASHKËFAJËSI NË GJENOCID, e ndëshkueshme në bazë të Neneve 4(3)(e) dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

PIKA 3 PËRNDJEKJET

33. Prej 1 marsit 1992 ose rreth asaj date deri më 31 dhjetor 1995, **Sillobodan MILLOSHEVIQI**, duke vepruar vetëm ose bashkë me anëtarë të tjerë të projektit të përbashkët kriminal, planifikoi, nxiti, urdhëroi, kreu ose përndryshe ndihmoi në planifikimin, përgatitjen dhe kryerjen e përndjekjeve të joserbëve, kryesisht myslimanë të Bosnjës dhe kroatë të Bosnjës që jetonin në viset e Banja Llukës, Bihaqit, Bijelinës, Bileqës, Bosanska Dubicës; Bosanska Gradishkës, Bosanska Krupës, Bosanski Novit; Bosanski Petrovacit, Bosanski Shamacit; Bratunacit; Bërçkës; Çajniçës, Çelinacit, Dobojit, Donji Vakëfit, Foçës; Gackës, Gorazhdës, Sarajevës (Haxhiqit); Sarajevës (Ilixhës); Sarajevë (Ilijashit); Kluçit; Kalinovikut, Kotor Varoshit; Nevesinjes, Sarajevës (Novi Gradit); Sarajevës (Sarajevës së Re); Sarajevës (Palles); Prijedorit; Përnjavorit, Rogaticëc; Rudos, Sanski Mostit; Shekoviqit; Shipovës, Sokolacit, Srebrenicës; Tesliqit, Trebinjës, Sarajevës (Tërnovës); Vishegradit; Vllasnicës, Sarajevës (Vogoshqës) dhe Zvornikut.

34. Gjatë tërë kësaj periudhe, forcat serbe, të përbëra prej njësive të APJ-së, UJ-së dhe USB-sëit, njësive lokale të Mbrojtjes Territoriale, njësive policore të MPB-së së Serbisë dhe njësive paramilitare prej Serbisë dhe Malit të Zi, sulmuan dhe morën nën kontroll qytete dhe fshatra në këto vise. Pas marrjes nën kontroll, forcat serbe në bashkëpunim me autoritetet vendëse serbe vendosën një regjim përndjekjesh me qëllim që të dëbohej popullata joserbe prej këtyre viseve.

35. Këto përndjekje u kryen në mënyrë diskriminuese mbi bazë të përkatësisë politike, racore ose fetare dhe përfshinin:

a) Shfarosjen ose vrasjen e mijërave myslimanëve të Bosnjës, kroatëve të Bosnjës dhe civilëve të tjerë joserbë, duke përfshirë gra dhe pleq, në viset e

lartpërmendur, hollësitat e të cilëve paraqiten në **Tabelat A dhe B** të bashkëngjitura kësaj aktakuze.

b) Burgimin dhe mbajtjen e tejkgjatur dhe të zakonshme të mijërave myslimanëve të Bosnjës, kroatëve të Bosnjës dhe civilëve të tjerë joserbë në objekte burgimi brenda dhe jashtë Bosnjës dhe Hercegovinës, hollësitat e të cilëve paraqiten në **Tabelën C** të bashkëngjitur kësaj aktakuze.

c) Krijimin dhe mbajtjen e kushteve çnjerëzore të jetesës për myslimanë të Bosnjës, kroatë të Bosnjës dhe civilë të tjerë joserbë brenda objekteve të lartpërmendur të burgimit. Kët kushte jetese ishin mizore dhe karakterizoheshin prej trajtimit çnjerëzor, ngushtësisë, urisë, punës të detyruar dhe keqtrajtimit sistematik fizik dhe psikologjik, duke përfshirë tortura, rrahje dhe sulme seksuale.

d) Punën e detyruar dhe të tejkgjatur dhe të shpeshtë për myslimanët e Bosnjës, kroatët e Bosnjës dhe civilë të tjerë joserbë në këto objekte burgimi. Puna e detyruar përfshinte hapjen e varreve dhe llogoreve dhe punë të tjera fizike në vijat e frontit.

e) Trajtimin mizor dhe çnjerëzor të myslimanëve të Bosnjës, kroatëve të Bosnjës dhe civilëve të tjerë joserbë gjatë dhe pas marrjes nën kontroll të komunave të lartpërmendura. Ky trajtim çnjerëzor përfshinte dhunë seksuale, tortura, keqtrajtim fizik dhe psikologjik, dhe kushte të imponuar çnjerëzore jetese, por nuk kufizohej vetëm me këto.

f) Zbatimin e masave shtrënguese dhe diskriminuese kundër myslimanëve të Bosnjës, kroatëve të Bosnjës dhe joserbëve të tjerër, si kufizimi i lirisë së lëvizjes; largimi nga pozitat e drejtuese në institucione të qeverisë lokale dhe polici; largimi nga puna; bastisje arbitrare të shtëpive të tyre; mohimi i së drejtës e procesit juridik dhe mohimi i së drejtës së barabartë për shërbime publike, duke përfshirë kujdesin e duhur mjekësor.

g) Rrahjen dhe plaçkitjen e myslimanëve të Bosnjës, kroatëve të Bosnjës dhe civilëve të tjerë joserbë.

h) Zhvendosjen e dhunshme dhe dëbimin e mijërave myslimanëve të Bosnjës, kroatëve të Bosnjës dhe civilëve të tjerë joserbë prej viseve të lartpërmendura, në vende jashtë viseve nën kontrollin serb, të përshkruar në paragrafët 40 dhe 41 si dhe në **Tabelën D** të bashkëngjitur kësaj aktakuze.

i) Përvetësimin dhe plaçkitjen e pronave së mijërave myslimanëve të Bosnjës, kroatëve të Bosnjës dhe civilëve të tjerë joserbë.

j) Shkatërrimin e qëllimshëm dhe të papërligjur të shtëpive dhe pronave të tjera publike dhe private të myslimanëve të Bosnjës dhe kroatëve të Bosnjës, të institucioneve kulturore dhe fetare të tyre, monumenteve historike dhe vende të tjera të shenjta, të përshkruar në paragrafin 42.

k) Pengimin e ndihmës humanitare, në veçanti furnizimet mjekësore dhe ushqimore për enklavat e rrethuara të Bihaqit, Gorazhdës, Srebrenicës dhe Zhepës dhe lënia pa ujë e civilëve të bllokuar në enklavat, më qëllim që të krijoheshin kushte të padurueshme jetese.

Me këto veprime dhe mosveprime, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** kreu:

Pika 3: Përndjekje mbi baza politike racore ose fetare, **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm sipas Neneve 5 (h), dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

PIKAT 4 deri në 7 SHFAROSJA, VRASJA DHE MARRJA E QËLLIMSHME E JETËS

36. Prej 1 marsit 1992 ose rreth asaj date deri më 31 dhjetor 1995, **Sllobodan MILLOSHEVIQI**, duke vepruar vetëm ose bashkë me anëtarë të tjerë të projektit të përbashkët kriminal, planifikoi, nxiti, urdhëro, kreu ose përndryshe ndihmoi në planifikimin, përgatitjen dhe kryerjen e shfarosjes, vrasjes dhe marrjes së qëllimshme të jetës së joserbëve, kryesisht myslimanë të Bosnjës dhe kroatë të Bosnjës që jetonin në viset e Banja Llukës, Bihaqit, Bijelinës; Bileqës, Bosanska Gradishkës, Bosanska Krupës, Bosanski Novit; Bosanski Petrovacit, Bosanski Shamacit; Bratunacit; Bërçkës; Çajniçës, Çelinacit, Dobojit, Foçës; Gackës, Sarajevës (Ilijashit); Kluçit; Kalinovikut, Kotor Varoshit; Nevesinjes, Sarajevës (Novi Gradit); Prijedorit; Përnjavorit, Rogaticës; Rudos, Sanski Mostit; Sokolacit, Srebrenicës; Tesliqit, Vishegradit; Vllasicës dhe Zvornikut. Shfarosja, vrasja dhe marrje e qëllimshme e jetës të këtyre grupeve u kryen nëpërmjet:

- a) Vrasjes së myslimanëve të Bosnjës, kroatëve të Bosnjës dhe joserbëve të tjerë në qytete dhe fshatra të tyre, gjatë dhe pas marrjes nën kontroll të viseve të lartpërmendura, duke përfshirë ato të përcaktuara në **Tabelën A** të bashkëngjitur kësaj aktakuze.
- b) Vrasjes së myslimanëve të Bosnjës, kroatëve të Bosnjës dhe joserbëve të tjerë në objekte burgimi dhe gjatë debimit ose zhvendosjeve të tyre të dhunshme, duke përfshirë ato të përcaktuara në **Tabelën B** të bashkëngjitur kësaj aktakuze.

Me këto veprime dhe mosveprime, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** kreu:

Pika 4: Shfarosje, **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të Neneve 5 (b), dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

Pika 5: Vrasje, **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të Neneve 5 (a), dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

Pika 6: Marrje të qëllimshme të jetës, **SHKELJE E RËNDË E KONVENTAVE TË GJENEVËS TË VITIT 1949**, e ndëshkueshme në bazë të Neneve 2(a), dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

Pika 7: Vrasje, **SHKELJE E LIGJEVE APO ZAKONEVE TË LUFTËS**, siç njihet në Nenin e Përbashkët 3(1)(a) e Konventave të Gjenevës të vitit 1949, e ndëshkueshme në bazë të Neneve 3 dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

PIKAT 8 deri në 15
HEQJA E PALIGJSHME E LIRISË, BURGIMI, TORTURA, SHKAKTIMI I
QËLLIMSHËN I VUAJTJES SE MADHE, VEPRIME TË TJERA
ÇNJEREZORE

37. Prej 1 marsit 1992 ose rreth asaj date deri më 31 dhjetor 1995, **Sillobodan MILLOSHEVIQI**, duke vepruar vetëm ose bashkë me anëtarë të tjerë të projektit të përbashkët kriminal, planifikoi, nxiti, urdhëro, kreu ose përndryshe ndihmoi në planifikimin, përgatitjen dhe kryerjen e heqjes së paligjshme të lirisë ose burgimit në kushte çnjerëzore të myslimanëve të Bosnjës kroatë të Bosnjës dhe joserbëve të tjerë që jetonin në viset e Banja Llukës, Bihaqit, Bijelinës; Bileqës, Bosanska Dubicës, Bosanska Krupës, Bosanski Novit; Bosanski Petrovacit, Bosanski Shamacit; Bratunacit; Bërçkës; Çajniçës, Çelinacit, Dobojit, Donji Vakëfit, Foçës; Gackës, Kluçit; Kalinovikut, Kotor Varoshit; Nevesinjes, Prijedorit; Përnjavorit, Rogaticës; Rudos, Sanski Mostit; Sokolacit; Tesliqit, Vishegradit; Vllasenicës dhe Zvornikut.

38. Forcat ushtarake serbe, të përbëra nga njësitë e APJ-së, UJ-së, UBS-së, Mbrojtjes Territoriale dhe njësitë paramilitare në bashkëpunim me personelin policor vendës dhe autoritetet serbe vendës arrestuan dhe mbajtën mijëra myslimanë të Bosnjës, Kroatë të Bosnjës dhe civilësh të tjerë joserbë nga viset e lartpërmendura. Këta civilë u mbajtën të burgosur për periudha të shkurtra ose të gjata; objektet kryesore të burgimit përmenden në **Tabelën C** të bashkëngjitur kësaj aktakuze.

39. Kushtet e jetesës në këto objekte burgimi ishin mizore dhe karakterizoheshin prej trajtim çnjerëzor, ngushtësisë, urisë, punës të detyruar dhe keqtrajtimit sistematik fizik dhe psikologjik, duke përfshirë tortura, rrahje dhe sulme seksuale.

Me këto veprime dhe mosveprime, **Sillobodan MILLOSHEVIQI** kreu:

Pika 8: Burgim, **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të Neneve 5 (e), dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

Pika 9: Torturë, **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të Neneve 5 (f), dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

Pika 10: Veprime çnjerëzore, **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të Neneve 5 (i), dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

Pika 11: Heqje e paligjshme e lirisë, **SHKELJE E RËNDË E KONVENTAVE TË GJENEVËS TË VITIT 1949**, e ndëshkueshme në bazë të Neneve 2(g), dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

Pika 12: Torturë, **SHKELJE E RËNDË E KONVENTAVE TË GJENEVËS TË VITIT 1949**, e ndëshkueshme në bazë të Neneve 2(b), dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

Pika 13: Shkaktim të qëllimshëm të vuajtjes së madhe, **SHKELJE E RËNDË E KONVENTAVE TË GJENEVËS TË VITIT 1949**, e ndëshkueshme në bazë të Neneve 2(c), dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

Pika 14: Torturë, **SHKELJE E LIGJEVE APO ZAKONEVE TË LUFTËS**, e njohur në Nenin e Përbashkët 3(1)(a) e Konventave të Gjenevës të vitit 1949, e ndëshkueshme në bazë të Neneve 3 dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

Pika 15: Trajtim mizor, **SHKELJE E LIGJEVE APO ZAKONEVE TË LUFTËS**, e njohur në Nenin e Përbashkët 3(1)(a) e Konventave të Gjenevës të vitit 1949, e ndëshkueshme në bazë të Neneve 3 dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

PIKAT 16 deri në 18

DËBIM DHE VEPRIME ÇNJERËZORE (ZHVENDOSJE TË DHUNSHME)

40. Prej 1 marsit 1992 ose rreth asaj date deri më 31 dhjetor 1995, **Sillobodan MILLOSHEVIQI**, duke vepruar vetëm ose bashkë me anëtarë të tjerë të projektit të përbashkët kriminal, planifikoi, nxiti, urdhëroi, kreu ose përndryshe ndihmoi në planifikimin, përgatitjen dhe kryerjen e zhvendosjes së paligjshme dhe të dhunshme, të cilësuar edhe si dëbim aty ku do të ndeshet këtej e tutje, të dhjetëra mijërave myslimanëve të Bosnjës, kroatëve të Bosnjës dhe civilëve të tjerë joserbë nga vendbanimet e tyre të ligjshëm në viset e Banja Llukës (dëbim), Bihaqit, Bijelinës; Bileqës (dëbim), Bosanska Dubicës, Bosanska Gradishkës, Bosanska Krupës, Bosanski Novit; Bosanski Petrovacit, Bosanski Shamacit (dëbim); Bratunacit; Bërçkës; Çajniçës, Çelinacit, Dobojit, Donji Vakëfit, Foçës; Gackës (dëbim), Sarajevës (Haxhiqit); Sarajevës (Ilijashit); Kluçit; Kalinovikut, Kotor Varoshit; Nevesinjes, Sarajevës (Novi Gradit); Sarajevës (Sarajevës së Re); Sarajevës (Palles); Prijedorit; Përnjavorit, Rogaticës; Rudos (dëbim), Sanski Mostit; Shekovcit, Shipovos, Sokolacit, Srebrenicës; Tesliqit, Trebinjes, Sarajevës (Tërnovës); Vishegradit; Villasenicës; Sarajevës (Vogoshqës) dhe Zvornikut (dëbim), në rajone të tjera brenda dhe jashtë Bosnjës dhe Hercegovinës. Hollësitrat e veprimeve dhe mosveprimeve të tilla përshkruhen në **Tabelën D**.

41. Për të arritur këtë synim, forcat serbe, të përbëra nga njësitë e APJ-së, UJ-së, USB-së, Mbrojtjes Territoriale dhe njësitë paramilitare në bashkëpunim me personelin policor vendës dhe autoritetet serbë dhe forcat speciale të Ministrisë së Punëve të Brendshme serbe nën kontrollin faktik të **Sillobodan MILLOSHEVIQIT** ose të anëtarëve të tjerë të projektit të përbashkët kriminal, pushtuan fshatra dhe qytete në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe morën pjesë me anëtarët e SDS-së në çarmatosjen e popullsisë joserbe. Qytetet dhe fshatrat pastaj u sulmuan, duke përfshirë edhe rajone në të cilat banorët u binden dhe nuk bënë qëndresë. Këto sulme synonin ta detyronin popullatën joserbe të largohej. Pas marrjes në kontroll të qyteteve dhe fshatrave, forcat serbe shpesh grumbulluan popullatën e mbetur civile joserbe dhe i larguan ata me dhunë nga zona. Në raste të tjerë, forcat serbe në bashkëpunim me autoritetet serbe vendosën masa shtërnguese dhe diskriminuese mbi popullatën joserbe dhe filluan një fushatë terrori me synim për t'i dëbuar ata prej zonës. Shumica e joserbëve që mbetën më në fund u dëbuann ose u zhvendosën prej shtëpive të tyre me dhunë.

Me këto veprime dhe mosveprime, **Sillobodan MILLOSHEVIQI** kreu:

Pika 16: Dëbim, **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të Neneve 5 (d), dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

Pika 17: Veprime Çnjerëzore (Zhvendosje me dhunë), **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të Neneve 5 (i), dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

Pika 18: Dëbim ose Zhvendosje e Paligjshme, **SHKELJE E RËNDË E KONVENTAVE TË GJENEVËS TË VITIT 1949**, e ndëshkueshme në bazë të Neneve 2(g), dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

PIKAT 19 deri në 22
SHKATËRRIM I PAPËRLIGJUR, PLAÇKITJE E PRONËS PUBLIKE OSE PRIVATE

42. Prej 1 marsit 1992 ose rreth asaj date deri më 31 dhjetor 1995, **Silobodan MILLOSHEVIQI**, duke vepruar vetëm ose bashkë me anëtarë të tjerë të projektit të përbashkët kriminal, planifikoi, nxiti, urdhëro, kreu ose përndryshe ndihmoi në planifikimin, përgatitjen dhe kryerjen e shkatërrimit të papërligjur dhe plaçkitjes së pronës publike dhe private të myslimanëve të Bosnjës, të kroatëve të Bosnjës dhe të popullsisë të tjera joserbe në viset e Banja Llukës, Bihaqit, Bijelinës; Bileqës, Bosanska Dubicës, Bosanska Gradishkës, Bosanska Krupës, Bosanski Novit; Bosanski Petrovacit, Bosanski Shamacit; Bratunacit; Bërçkës; Çajniçës, Çelinacit, Dobojit, Donji Vakëfit; Foçës; Gackës, Sarajevës (Haxhiqit); Sarajevës (Ilixhës); Sarajevës (Ilijashit); Kluçit; Kalinovikut, Kotor Varoshit; Nevesinjes, Sarajevës (Novi Gradit); Sarajevës (Sarajevës së Re); Sarajevës (Palles); Prijedorit; Përnjavorit, Rogaticës; Rudos, Sanski Mostit; Shekovcit, Shipovës, Sokolacit, Srebrenicës; Tesliqit, Sarajevës (Tërnovës); Trebinjës, Vishegradit; Vllasenicës; Sarajevës (Vogoshqës) dhe Zvornikut. Ky shkatërrim i qëllimshëm dhe i papërligjur dhe kjo plaçkitje nuk ishin të justifikuar nga domosdoshmeria ushtarake dhe përfshinin:

- a) Përvetësimin dhe plaçkitjen e pronësisë së civilëve myslimanë të Bosnjës, të kroatëve të Bosnjës dhe të civilëve të tjerë joserbë, duke përfshirë nënshkrimin me detyrim të dokumenteve duke hequr dorë nga të drejtat e pronësisë.
- b) Shkatërrimin e qëllimshëm dhe të papërligjur të shtëpive dhe të pronave të tjera të civilëve myslimanë të Bosnjës, të kroatëve të Bosnjës dhe të civilëve të tjerë joserbë. Ky lloj shkatërrimi u përdor si mjet për të detyruar joserbët që të iknin nga vendbanimet e tyre të ligjshme dhe për të parandaluar kthimin e tyre më vonë.
- c) Shkatërrimin e qëllimshëm dhe të papërligjur të godinave fetare dhe kulturore të bashkësive të myslimanëve të Bosnjës dhe kroatëve të Bosnjës, duke përfshirë ndër të tjera xhami, kisha, biblioteka, objekte arsimore dhe qendra të kulturës.

Me këto veprime dhe mosveprime, **Silobodan MILLOSHEVIQI** kreu:

Pika 19: Shkatërrim në një shkallë të gjerë dhe përvetësim të pronësisë, të pajustificuar nga domosdoshmëria ushtarake dhe të kryer në mënyrë të paligjshme dhe të papërligjur, **SHKELJE E RËNDË TË KONVENTAVE TË GJENEVËS TË VITIT 1949**, e ndëshkueshme në bazë të Neneve 2(d), dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

Pika 20: Shkatërrim të papërligjur të fshatrave, ose shkretim të pajustificuar nga domosdoshmëria ushtarake, **SHKELJE E LIGJEVE APO ZAKONEVE TË LUFTËS**, e ndëshkueshme në bazë të Neneve 3 (B), dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

Pika 21: Shkatërrim të qëllimshëm ose dëmtim të qëllimshëm të monumenteve historike dhe institucioneve kushtuar arsimit ose fesë, **SHKELJE E LIGJEVE APO ZAKONEVE TË LUFTËS**, e ndëshkueshme në bazë të Neneve 3 (d), dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

Pika 22: Plaçkitje të pronës publike ose private, **SHKELJE E LIGJEVE APO ZAKONEVE TË LUFTËS**, e ndëshkueshme në bazë të Neneve 3 (e), dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

PIKAT 23 deri në 29
VRASJE, MARRJE E QËLLIMSHME E JETËS, SHKAKTIMI I
QËLLIMSHËM I VUAJTJES SË MADHE, TRAJTIM MIZOR, SULME
KUNDËR CIVILËVE

43. Prej prillit 1992 deri në nëntor 1995, **Sillobodan MILLOSHEVIQI**, duke vepruar vetëm ose bashkë me anëtarë të tjerë të projektit të përbashkët kriminal, planifikoi, nxiti, urdhëroi, kreu ose përndryshe ndihmoi në planifikimin, përgatitjen dhe kryerjen e një fushate ushtarake të granatimeve me artileri dhe minahedhës dhe të qitjes me snajperë në lagje civile të Sarajevës dhe mbi popullatën civile të Sarajevës, duke vrarë dhe plagosur mijëra civilëve të të gjitha moshave dhe të të dyja gjinive.

44. Në këtë periudhë, Korpusi “Romania” i Sarajevës i UBS-së, nën kontrollin faktik të Radovan KARAGJIQIT dhe të Gjeneralit Ratko MLLADIQ filloi një sulm në shkallë të gjerë me granatime dhe qitje snajperësh mbi Sarajevën, kryesisht nga pozicionet në kodrat rreth qytetit me një pamje të qartë të Sarajevës, me një kohëzgjatje prej dyzetekatër muajsh,.

45. Korpusi “Romania” i Sarajevës kreu një fushatë të tejzgjatur granatimi dhe qitjeje snajperike kundër Sarajevës, gjatë së cilës civilët ose u morën në shënjeshtër qëllimisht ose u bënë cak i të shtënave kuturu në lagje ku dihej se ndodheshin civilë. Ndër viktimat e kësaj fushate pati civilë të cilët, ndër të tjera, punonin në kopshte perimesh, pritnin në rradhë për bukë ose ujë, merrnin pjesë në funerale. blenin në pazare, udhëtonin me tramvaj, ose mblidhnin dru. Raste të veçanta të qitjes snajperike përshkruhen në **Tabelën E**, të bashkëngjitur kësaj aktakuze. Raste të veçanta granatimi jepen në **Tabelën F**.

Me këto veprime dhe mosveprime, **Sillobodan MILLOSHEVIQI** kreu:

Pika 23: Vrasje, **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të Neneve 5 (a), dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

Pika 24: Veprime çnjerëzore **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të Neneve 5 (i), dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

Pika 25: Marrje të qëllimshme të jetës, **SHKELJE E RËNDË E KONVENTAVE TË GJENEVËS TË VITIT 1949**, e ndëshkueshme në bazë të Neneve 2(a), dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

Pika 26: Shkaktim të qëllimshëm të vuajtjes së madhe, **SHKELJE E RËNDË E KONVENTAVE TË GJENEVËS TË VITIT 1949**, e ndëshkueshme në bazë të Neneve 2(c), dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

Pika 27: Vrasje, **SHKELJE E LIGJEVE APO ZAKONEVE TË LUFTËS**, e njohur në Nenin e Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të Vitit 1949, e ndëshkueshme në bazë të Neneve 3, dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

Pika 28: Trajtim mizor, **SHKELJE E LIGJEVE APO ZAKONEVE TË LUFTËS**, e njohur në Nenin e Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të Vitit 1949, e ndëshkueshme në bazë të Neneve 3, dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

Pika 29: Sulme kundër civilëve, **SHKELJE E LIGJEVE APO ZAKONEVE TË LUFTËS**, e njohur në Nenin 51 (2) të Protokollit Shtese I dhe Nenin 13 (2) të Protokollit Shtese II të Konventave të Gjenevës të Vitit 1949, e ndëshkueshme në bazë të Neneve 3, dhe 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit.

PRETENDIME TË PËRGJITHSHME JURIDIKE

46. Te gjitha veprimet dhe mosveprimet e pretenduara në këtë aktakuzë ndodhën në territorin e ish-Jugosllavisë.

47. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, në Bosnjë dhe Hercegovinë ekzistonte një gjendje konflikti ndërkombëtar me armë dhe pushtimi të pjesshëm.

48. Të gjitha veprimet dhe mosveprimet që akuzohen si shkelje të rënda të konventave të Gjenevës të vitit 1949 ndodhën gjatë konfliktit ndërkombëtar me armë dhe pushtimit të pjesshëm të Bosnjës e Hercegovinës. Të gjitha këto veprime dhe mosveprime u kryen kundër personave të mbrojtur sipas Konventave të Gjenevës.

49. Të gjitha veprimet dhe mosveprimet që lidhen me akuzat për shkatërrimin e pronës, si shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës të vitit 1949 kishin të bënin me “pronë të mbrojtur” sipas dispozitave përkatëse të Konventave të Gjenevës.

50. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Silobodan MILLOSHEVIQI** ishte i detyruar që t’u përmbahej ligjeve dhe zakoneve që rregullojnë zhvillimin e konflikteve me armë, duke përfshirë Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokollat Shtojtë që u janë bashkëngjitur.

51. Çdo sjellje që përbën akuzë për Krime Kundër Njerëzimit ishte pjesë e një sulmi të gjerë ose sistematik të drejtuar kundër popullatës civile -- myslimanëve të Bosnjës, Kroatëve të Bosnjës dhe popullatës së tjerë joserbe në shumë pjesë të Bosnjës dhe Hercegovinës.

FAKTE SHITESË

52. Zgjedhjet shumëpartiake u mbajtën në Bosnjë e Hercegovinë në nëntor të vitit 1990. Në nivel të republikës, SDA-ja (*Stranka Demokratske Akcije – Partia e Veprimit Demokratik*), partia e myslimanëve të Bosnjës, fitoi 86 vende; SDS-ja, partia e serbëve të Bosnjës, fitoi 72 vende dhe HDZ-ja (*Hrvatska Demokratska Zajednica -- Bashkësia Demokratike Kroate*) fitoi 44 vende në Kuvend.

53. Thelbi i platformës politike të SDS-së, i shprehur nga udhëheqësit partiakë duke përfshirë Radovan KARAGJIQIN, Momçillo KRAJISHNIKUN dhe Biljana PLLAVSHIQIN ishte bashkimi i të gjithë serbëve në një shtet. SDS-ja e konsideroi shkëputjen e Bosnjës nga RSFJ-ja si kërcënim ndaj interesave të serbëve.

54. Më 5 shkurt 1991, Kuvendi i Republikës së Serbisë miratoi një “Ligj mbi Ministrinë” të propozuar nga **Sillobodan MILLOSHEVIQI**. Ky ligj krijoi 20 “Ministri” të qeverisë serbe, duke përfshirë Ministrinë për Lidhje me Serbë jashtë Serbisë. Kjo Ministri e ndihmoi SDS-në për të themeluar Republikën Serbe të Bosnjës e Hercegovinës.

55. Rezultateve e zgjedhjeve të nëntorit 1990 treguan se me kalimin e kohës SDS-ja nuk do të ishte në gjendje për të mbajtur me mjete paqësore Republikën e Bosnjës e Hercegovinës brenda një Jugosllavie që gjithnjë më shumë dominohej prej serbëve. Si pasojë, popullsia serbe brenda viseve të caktuara të Bosnjës dhe Hercegovinës me shumicë serbe filloi të organizohej në struktura formale rajonale të quajtura “bashkësi të komunave”. Në prill 1991 u themelua Bashkësia e Komunave të Krajines së Bosnjës me qendër në Banja Llukë.

56. Në mars 1991, Kryesia kolektive e RSFJ-së u bllokua lidhur me disa çështje duke përfshirë çështjen e shpalljes së një gjendjeje të jashtëzakonshme në Jugosllavi. Përfaqësuesit në Kryesi nga Republika e Serbisë, Republika e Malit të Zi, Krahina Autonome e Vojvodinës dhe Krahina autonome e Kosovës dhe Metohisë dhanë të gjithë dorëheqje nga postet e tyre. Më 16 mars 1991, në një fjalim të transmetuar në televizion, **Sillobodan MILLOSHEVIQI** në cilësinë e Kryetarit të Republikës së Serbisë, deklaroi se Jugosllavia kishte marrë fund dhe se Serbia nuk do t’u bindej më vendimeve të Kryesisë Federale.

57. Më 25 mars 1991, **Sillobodan MILLOSHEVIQI** dhe Franjo TUGJMANI u takuan në Karagjorgjevë dhe diskutuan ndarjen e Bosnjës e Hercegovinës midis Serbisë dhe Kroacisë.

58. Më 25 qershor 1991, Sllovenia dhe Kroacia shpallën pavarësinë e tyre. Më 26 qershor, APJ-ja ndërhyri në Slloveni. Luftimet në Kroaci shpërthyen në verën e vitit 1991.

59. Në gusht 1991, Radovan KARAGJIQI krijoi një sistem të komunikimit të fshehtë midis komiteteve lokalë të SDS-së dhe Shtabit Qendror dhe me Republikën e Serbisë. Ky protokoll i komunikimit të fshehtë u shpall i detyrueshëm për transmetimin e raporteve dhe urdhrave.

60. Prej vjeshtës së vitit 1991, APJ-ja filloi t'i tërhiqte forcat nga Kroacia. Forcat nën kontrollin e APJ-së filluan të ridislokoreshin në Bosnjë dhe Hercegovinë. Shumë prej këtyre forcave u dislokuan në vise ku nuk kishte kazerma apo objekte të tjerë të APJ-së.

61. Me vazhdimin e luftës në Kroaci, shpallja e pavarësisë së Bosnjës dhe Hercegovinës nga RSFJ-ja po bëhej gjithnjë më e mundur. SDS-ja, duke kuptuar se nuk mund të ndalte shkëputjen e Bosnjës dhe Hercegovinës nga RSFJ-ja, filloi të krijonte një entitet të veçantë serb brenda Bosnjës e Hercegovinës. Gjatë periudhës prej shtatorit deri në nëntor 1991, u formuan disa krahina autonome serbe (SAO), disa prej tyre në bazë të bashkësive të komunave të lartpërmendura.

62. Më 12 shtator 1991, u shpall Krahina Autonome Serbe e Hercegovinës. Më 16 shtator 1991 u shpall Krahina Autonome e Krajnës nga Kuvendi i Bashkësisë së Komunave të Krajnës së Bosnjës. Më 21 nëntor 1991, Krahinat Autonome Serbe dhe Krahinat Autonome ishin Krahina Autonome e Krajnës, Krahina Autonome Serbe e Hercegovinës, Krahina Autonome Serbe e Romanija-Biraçit, Krahina Autonome Serbe e Semberijës dhe Krahina Autonome Serbe e Bosnjës Veriore.

63. Më 3 tetor 1991, të katër anëtarët e Kryesisë së RSFJ-së nga Serbia dhe Mali i Zi (Borisav JOVIQ, Jugosllav KOSTIQ, Sejdo BAJRAMOVIQ dhe Brank KOSTIQ) morën përsipër detyrat e Kryesisë së RSFJ-së, duke anashkaluar rolin dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Kryesisë nga Sllovenia, Kroacia, Bosnja e Hercegovina dhe Maqedonia.

64. Më 15 tetor 1991, në një mbledhje të Këshillit Partiak të SDS-së, u mor vendimi që të formohej një kuvend i veçantë për të siguruar interesat serbe, i quajtur "Kuvendi i Popullit Serb të Bosnjës dhe Hercegovinës".

65. Më 22 tetor 1991 ose rreth kësaj date, **Slobodan MILLOSHEVIQI**, bashkë me anëtarë të tjerë të projektit të përbashkët kriminal, vazhdoi të mbështeste idenë e një shteti të bashkuar serb, të qeverisur prej Beogradit, në Serbi. Në të njëjtën datë, "Kryesia e Mbetur" bëri thirrje për mobilizimin e rezervistëve në Serbi dhe "vise të tjera që dëshirojnë të mbesin në Jugosllavi."

66. Më 26 tetor 1991 ose rreth kësaj date, Radovan KARAGJIQI deklaroi mobilizimin e plotë të Mbrojtjes Territoriale dhe formimin e njërive në terren në Republikën Serbe të Bosnjës e Hercegovinës.

67. Më 24 tetor 1991, Kuvendi i Popullit Serb në Bosnjë Hercegovinë, i dominuar nga SDS-ja, vendosi të mbante një "Referendum të Popullit Serb në Bosnjë e Hercegovinë" për të vendosur në se do të mbesnin në shtetin e përbashkët të Jugosllavisë me Serbinë, Malin e Zi, Krahinën Autonome Serbe të Krajnës, Krahinën Autonome Serbe të Sllavonisë Perëndimore dhe Krahinën Autonome Serbe të Sllavonisë Lindore, Baranjës dhe Sremit Perëndimor.

68. Më 9 dhe 10 nëntor 1991, Serbët e Bosnjës zhvilluan referendumin për çështjen në se Bosnja dhe Hercegovina do të mbetej në Jugosllavi ose do të bëhej shtet i pavarur. Rezultatet treguan se shumica dërrmuese e serbëve të Bosnjës dëshironin të mbeteshin në Jugosllavi.

69. Më 21 nëntor 1991, Kuvendi i Popullit Serb të Bosnjës dhe Hercegovinës shpalli si pjesë të territorit të shtetit federal jugosllav të gjitha ato komuna, bashkësi lokale dhe vendbanime në të cilat mbi 50 per qind e popullsisë të kombësisë serbe kishin votuar në referendum për të mbetur në këtë shtet, si edhe ato vende ku qytetarët e kombësive të tjera ishin shprehur për të mbetur në Jugosllavi.

70. Më 11 dhjetor 1991, Kuvendi i Popullit Serb dorëzoi një kërkesë të hollësishme për APJ-në, që të mbronte me të gjitha mjete që kishte në dispozicion, si “pjesë përbërëse të shtetit të Jugosllavisë” territoret e Bosnjës dhe Hercegovinës në të cilat u zhvillua referendumi i popullsisë serbe dhe qytetarëve të tjerë për të mbetur në një shtet të përbashkët jugosllav.

71. Më 19 dhjetor 1991, SDS-ja lëshoi udhëzime për “Organizimin dhe Veprimtarinë e Organeve të Popullit Serb në Bosnjë e Hercegovinë në Rrethana të Jashtëzakonshme”, të cilat i siguruan SDS-së një plan për marrjen e pushtetit në komunat e Bosnjës e Hercegovinës.

72. Më 9 janar 1992, Kuvendi i Popullit Serb në Bosnjë e Hercegovinë miratoi një deklaratë për Shpalljen e Republikës Serbe të Bosnjës e Hercegovinës. Territori i asaj republike u deklarua se përfshinte “territoret e Krahinave dhe Rajoneve Autonome Serbe dhe të entiteteve të tjera të etnisë serbe në Bosnjë e Hercegovinë, duke përfshirë rajonet në të cilat populli serb kishte mbetur pakicë për shkak të gjenocidit të ushtruar kundër tij gjatë Luftës së Dytë Botërore,” dhe u deklarua si pjesë e shtetit federal jugosllav. Më 12 gusht 1992, emri i Republikës Serbe të Bosnjës u ndërrua në Republika Srpska.

73. Prej 29 shkurtit deri më 2 mars 1992, Bosnjë e Hercegovina mbajti një referendum për pavarësinë. Të nxitur nga SDS-ja, shumica e serbëve të Bosnjës e bojkotuan votimin. Rezultatet e referendunit treguan se shumica e përkrahnin pavarësinë.

74. Më 18 mars 1992, gjatë seancës së 11-të të Kuvendit të Popullit Serb, u arrit përfundimi që të “përgatiteshen për seancën e ardhshme propozime për marrjen e pushtetit në Republikën e Popullit Serb në Bosnjë e Hercegovinë.”

75. Prej marsit të vitit 1992, forcat e rregullta dhe të parregullta serbe morën nën kontroll vise brenda Bosnjës e Hercegovinës, duke përfshirë ato të përcaktuara në këtë aktakuzë.

76. Më 6 prill 1992, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkësia Europiane njohën zyrtarisht pavarësinë e Bosnjës e Hercegovinës.

77. Më 27 prill 1992, Serbia dhe Mali i Zi shpallën Republikën e re Federale të Jugosllavisë dhe e shpallën shtet pasues të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë.

78. Më 12 maj 1992, në Kuvendin e 16-të të Popullit Serb në Bosnjë e Hercegovinë, Radovan KARAGJIQI shpalli të gjashtë synimet strategjike të Popullit Serb në Bosnjë e Hercegovinë. Këto synime përfshinin fshirjen e lumit Drin si kufi midis shteteve serbe. Gjatë së njëjtës seance, Gjenerali Ratko MLLADIQ i tha Kuvendit se nuk do të ishte e mundshme që të ndanin serbët prej joserbëve dhe joserbët thjesht të largoheshin prej territorit. Ai paralajmëroi se kjo përpjekje do të përfundonte në gjenocid.

79. Më 15 maj 1992, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, në Rezolutën e tij Nr. 752, kërkoi ndërprerjen e menjëhershme të çdo ndërhyrjeje nga jashtë Bosnjës e Hercegovinës nga ana e njësisë të APJ-së dhe këto njësi ose të tërhiqeshin, t'i nënshtroheshin autoritetit të Qeverisë së Republikës, ose të shpërndareshin dhe të çarmatoheshin.

Carla del Ponte
Prokurore

Sot, me datën 22 nëntor 2001
Hagë, Holandë

LISTA A
VRASJE QË NUK LIDHEN ME OBJEKTE BURGIMI

Nr.	Komuna	Viktimat (Të Vrarët)	Data
1	Banja Luka	Në Qullum-Kostiq u vranë 5 joserbë	15 gusht 1992
2	Bihaq	Në Orashce dhe Dulci, u vranë afro 18 joserbë	20 – 22 shtator 1992
3	Bijellina	Në Bijelinë, u vranë se paku 48 meshkuj, femra dhe fëmijë, myslimanë të Bosnjës dhe/apo kroatë të Bosnjës.	1 – 2 prill 1992
4	Bosanska Gradishka	Vrasja e së paku 4 civilëve myslimanë të Bosnjës afër tregut në Bosanska Gradishkë	15 gusht 1992
5	Bosanski Novi	Në Bllagaj Japra, 7 myslimanë të Bosnjës u vranë gjatë debimit të myslimanëve të Bosnjës	9 qershor 1992
		Në Alliqi, u vranë 27 myslimanë të Bosnjës	23 qershor 1992
6	Bosanski Petrovc	Vrasja e së paku 2 myslimanëve afër Hujiqeve	20 shtator 1992
7	Bratunac	Në Gllogovë, rreth 65 civilë, myslimanë të Bosnjës dhe kroatë të Bosnjës, u vranë nga anëtarët e APJ-së, duke vepruar bashkë me forcat paramilitare serbe	9 maj 1992
8	Bërçko	Në Bërçko, rreth 12 meshkuj, myslimanë të Bosnjës dhe joserbë të tjerë u vranë në Hotel Posavina	4 maj 1992
9	Çellinac	Rifet MUJKANOVIQI, i vranë me armë zjarri prej një ushtari serb	31 korrik 1992
		Vrasja e dy civilëve joserbë prej ushtarëve serbë	2 gusht 1992
10	Doboj	Në Grapskë të Epërme, rreth 24 civilë, myslimanë të Bosnjës, u vranë gjatë granatimit të fshatit.	10 maj 1992
11	Foça	Në Gjigjevë, se paku 11 meshkuj, myslimanë të Bosnjës, u ekzekutuan prej ushtarëve serbë.	20 prill 1992
		Në Filipoviqi, se paku 5 myslimanë të Bosnjës u vranë prej ushtarëve serbë në një depo ushtarake.	26 prill 1992
		Në Jelleç, 18 myslimanë të Bosnjës, duke përfshirë pleq dhe 8 anëtarë të një familjeje, u ekzekutuan prej ushtarëve të APJ-së	4 – 10 maj 1992
		Në Brod, 14 meshkuj, myslimanë të Bosnjës nga Tërnovci, u ekzekutuan prej ushtarëve serbë	22 qershor 1992
12	Gacko	Se paku 5 joserbë u vranë në fshatin Meduliqi	17 qershor 1992
		2 meshkuj myslimanë u vranë prej ushtarëve serbë afër Malit të Zellengorës	18 qershor 1992
		Se paku 8 myslimanë u vranë prej ushtarëve serbë afër Malit të Zellengorës.	18-23 qershor 1992
13	Kluç	Në Pudin Han, 11 civilë joserbë të Bosnjës u vranë gjatë sulmit serb mbi fshatin.	27 maj 1992
		Në Përrovë, 38 fshatarë myslimanë të Bosnjës, duke përfshirë gra dhe fëmijë, u vranë nga të shtënat dhe granatat.	1 qershor 1992
		Afër Peqit, 9 meshkuj, myslimanë të Bosnjës, u vranë prej ushtarëve serbë.	1 qershor 1992
		Në Velagiqi, u vranë rreth 100 meshkuj, myslimanë të Bosnjës.	1 qershor 1992.
14	Kotor-Varosh	Në qytetin e Kotor Varoshit, rreth 13 joserbë u vranë në Qendrën Shëndetësore dhe rreth saj.	25 qershor 1992
		Në një hambar në Dabovc, u vranë së paku 15 meshkuj, myslimanë të Bosnjës.	gusht 1992.
		Në Vërbanjci, në kafene Allagiq dhe rreth saj u vranë 7	25 qershor 1992.

Nr.	Komuna	Viktimat (Të Vrarët)	Data
		meshkuj, myslimanë të Bosnjës,.	
		Në Grabovicë, një numër i madh të arrestuarish, myslimanë dhe kroatë të Bosnjës, u mbajtën në shkollën e Grabovicës. Atje u rrahën dhe nuk u panë më.	nëntor 1992
15	Nevesinje	U vranë se paku 34 meshkuj, femra dhe fëmijë, civilë myslimanë të Bosnjës, në Lipovac dhe Dubrovac ose afër tyre.	qershor-korrik 1992
		Afro 17 civilë, myslimanë të Bosnjës, u vranë nga ushtarët serbë afër Kiserit.	në mes të korrikut 1992
16	Prijedor	Shumë joserbë u vranë në rajonin e Bërdës.	korrik 1992
		Në Hambarinë dhe Behliq u vranë se paku 3 myslimanë të Bosnjës.	11 qershor-1 korrik 1992
		Në Kamiçani, në shtëpinë e Mehmed Shahoriqit u vranë afro tetë joserbë.	26 maj 1992
		Në Jaskiq, u vranë se paku 19 meshkuj, myslimanë të Bosnjës	14 qershor 1992
		Rreth 40 joserbë u vranë në Bishqani	20 korrik 1992
		Se paku 19 myslimanë të Bosnjës u vranë në Çarakovë.	23 korrik 1992
		Se paku 68 joserbë u vranë gjatë sulmit në Brishevë.	24 korrik 1992
		Se paku 8 meshkuj, myslimanë të Bosnjës, u vranë në minierën e xeherorit të hekurit të Kipesë (afër Lubisë)	25 korrik 1992
		Se paku 3 meshkuj, myslimanë të Bosnjës, u vranë në Stadium e Futbollit në Lubi.	25 korrik 1992
		4 joserbë u vranë në Tomashicë.	3 dhjetor 1992
17	Përnjavor	8 civilë myslimanë të Bosnjës, nga Derventa u vranë në Kremnë.	prill 1992
		Në Lishnjë, u ekzekutuan 4 meshkuj, myslimanë të Bosnjës.	maj 1992
18	Rudo	Së paku 50 civilë joserbë u vranë gjatë marrjes së pushtetit, në ekzekutime masive në Setovë, Vranj, Mërsovë dhe në masakra në Shërpçi dhe Sjeverin.	maj 1992
		Rreth 40 pleq, civilë joserbë, u vranë.	maj 1992.
		Një numër myslimanësh u vranë në kodrën e Vranjës.	2 gusht 1992
19	Sanski Most	Se paku 24 gra dhe fëmijë, myslimanë të Bosnjës, u vranë në Hrustovë.	31 maj 1992
		Se paku 13 meshkuj, myslimanë të Bosnjës, nga Begiqi, u vranë në urën e Vërhpoles ose pranë saj.	31 maj 1992
		Një numër joserbësh u vranë afër varrezës së Partizanëve në Sanski Most.	22 qershor 1992.
		Në Kenjari, 19 meshkuj, myslimanë të Bosnjës, u vranë në shtëpinë e Dujo Banoviqit.	27 qershor 1992.
		12 anëtarë të një familjeje u vranë në Budin.	1 gusht 1992
		5 meshkuj, kroatë të Bosnjës u vranë në Donji Kruhari, afër Shkërlevitës.	2 nëntor 1992
		Rreth 11 meshkuj joserbë u ekzekutuan nga anëtarët e Tigrave të Arkanit në Tërnovë, afër qytetit të Sanski Mostit.	20 shtator 1995
		Në Sasinë, se paku 65 meshkuj joserbë u ekzekutuan nga anëtarët e Tgrave të Arkanit, nën komandën e drejtpërdrejtë të Arkanit.	21 shtator 1995
20.	Sokollac	Afro 7 fshatarë joserbë u vranë nga serbët në një masakër në fshatin Toçionik.	21 korrik 1992
		3 plaka joserbe u vranë në fshatin Melinë.	31 korrik 1992

Nr.	Komuna	Viktimat (Të Vrarët)	Data
		Dy joserbë u vranë në fshatin Zhul.	1 gusht 1992
21	Srebrenicë	Pas marrjes së Srebrenicës, disa mijëra meshkuj, myslimanë të Bosnjës, u ekzekutuan nga forcat serbe të Bosnjës. në këto vende, ndër të tjera:	korrik 1995
		1) Lugina e Cerskës, afro 150 meshkuj, myslimanë të Bosnjës;	13 korrik 1995
		2) Depo në Kravicë (Komuna e Zvornikut), rreth 1,000 meshkuj, myslimanë të Bosnjës;	13 korrik 1995.
		3) Orahovac (Komuna e Zvornikut), rreth 1,000 meshkuj, myslimanë të Bosnjës;	14 korrik 1995.
		4) Diga e Petkovcit (Komuna e Zvornikut), rreth 1,500 – 2,000 meshkuj, myslimanë të Bosnjës;	14/15 korrik 1995.
		5) Ferma ushtarake e Branjevës (Komuna e Zvornikut), rreth 1,000 – 1,200 meshkuj myslimanë të Bosnjës;	16.korrik 1995.
		6) Shtëpia e Kulturës në Pilicë (Komuna e Zvornikut); rreth 500 meshkuj, myslimanë të Bosnjës;	16 korrik 1995.
		7) Kozlluk (Komuna e Zvornikut), se paku 340 meshkuj, myslimanë të Bosnjës;	15/16 korrik 1995.
22	Vishegrad	Afër Vidova Gorës, se paku 11 joserbë, duke përfshirë gra dhe fëmijë, u ekzekutuan dhe u hodhën në Lumin Drin.	qershor 1992.
		Në Mëhallën e Re (qyteti i Vishegradit), mbi 60 civilë, myslimanë të Bosnjës dhe/apo Kroatë të Bosnjës, u dogjën për se gjalli në një shtëpi të ndezur nga paramilitarët serbë nën komandën e Millan Llukiqit.	14 qershor 1992.
		Në vendbanimin Bikavac, rreth 70 civilë, myslimanë të Bosnjës dhe joserbë të tjerë u dogjën për se gjalli në një shtëpi të ndezur nga paramilitarët nën komandën e Millan Llukiqit	27 qershoir 1992
23	Vilasinicë	Në Drum (qyteti i Vilasinicës), u vranë rreth 22 meshkuj, myslimanë të Bosnjës.	qershor 1992.
		Në Zaklopaça, se paku 58 meshkuj, gra dhe fëmijë, myslimanë të Bosnjës, u ekzekutuan gjatë sulmit serb mbi fshatin.	16 maj 1992.
24	Zvornik	Në qytetin e Zvornikut, 15 meshkuj, myslimanë të Bosnjës dhe kroatë të Bosnjës, u ekzekutuan nga ushtarët e Arkanit.	9 prill 1992.
		Se paku 55 meshkuj, myslimanë të Bosnjës, u vranë në Drinjaça	30 maj 1992.
25	Ilijash (rrethina e gjerë e Sarajevës)	21 myslimanë të Bosnjës u vranë në Leshevë.	4 qershor 1992.

LISTA B
VRASJE QË LIDHEN ME OBJEKTE BURGIMI

Nr.	Komuna	Viktimat (Të Vrarët)	Data
1	Banja Luka	Në kampin e Manjaçës u vranë 2 joserbë	6 gusht – 18 shtator 1992
		Në kampin e Manjaçës, rreth 7 joserbë u vranë pasi u transportuan nga Salla e Sportit "Hasan Kikiqi" në Sanski Most	3 ose 4 qershor 1992
		Midis kampit të Kringsit dhe kampit të Manjaçës, se paku 20 meshkuj joserbë u vranë gjatë transportimit midis kampeve.	4 korrik 1992.
		Në kampin e Manjaçës, se paku 8 joserbë u vranë para kampit pas transportimit prej Kampit të Omarskës	6 gusht 1992
2	Bileqa	Në objektin e burgimit të SPB-së, 2 të arrestuar joserbë të vranë	25 qershor – 18 dhjetor 1992.
3	Bosanska Krupa	Në shkollën fillore "Petar Koçiqi", u vranë rreth 11 të arrestuar joserbë	1-10 gusht 1992.
4	Bosanski Shamac	Në kampin Cërkvinë, u vranë afro 17 të arrestuar joserbë.	6 maj 1992
5	Bratunac	Se paku 14 meshkuj joserbë u vranë në Shkollën "Vuk Karaxhiqi"	10-16 maj 1992.
6	Bërçko	Në kampin e Llukës, rreth 30-35 të arrestuar, myslimanë të Bosnjës u ekzekutuan.	11-16 maj 1992
7	Çajnice	53 joserbë të vranë në shtëpinë e gjuetisë në Mostinë	19 maj 1992.
8	Foça	U vranë një numër të arrestuarish joserbë në kampin Livade.	13-18 prill 1992
		Se paku 266 të arrestuar myslimanë të Bosnjës u vranë në burgun "KP Dom"	qershor-dhjetor 1992.
9	Gackë	5 meshkuj të Bosnjës u vranë në godinën e SPB-së në Gackë	3 korrik 1992.
10	Kallinovik	Rreth 23 burra dhe djem myslimanë nga depoja e barutit u vranë në një fushë afër Ratinës.	5 gusht 1992.
11	Ključ	Së paku 30 pleq myslimanë u vranë në Biljani.	10 korrik 1992.
12	Prijedor	Së paku 2 joserbë u vranë në kampin e Tërropolës.	28 maj – tetor 1992.
		Qindra myslimanë të Bosnjës dhe kroatë të Bosnjës u vranë në kampin Omarska.	maj-gusht 1992.
		U vranë rreth 150 joserbë në kampin Keraterm.	24 korrik 1992.
		Rreth 200 meshkuj myslimanë të Bosnjës dhe/ose kroatë të Bosnjës nga kampi i Tërropolës u vranë në malin Vlasiq në komunën e Skënder Vakufit.	21 gusht 1992.
13	Rogatica	Afër Cërvenkës, u ekzekutuan se paku 10 meshkuj, myslimanë të Bosnjës nga Vishegradi.	15 qershor 92.
14	Rudo	Së paku një plak mysliman u vra në kampin e burgimit në kazemat e APJ-së.	në vitin 1992 ose afër tij.
		Së paku një mysliman u vra në kampin e burgimit në kazemat e APJ-së.	në vitin 1992 ose afër tij.

Nr.	Komuna	Viktimat (Të Vrarët)	Data
15	Sanski Most	Afër Hrastove Glavicës, u vranë rreth 10 meshkuj joserbë të marrë nga Keratermi dhe Omarska.	5 gusht 1992
		Në qytetin e Sandki Mostit, u vranë nga Tigrat e Arkanit se paku 2 meshkuj joserbë në Hotel Sana.	18-21 shtator 1992.
		Se paku 10 meshkuj joserbë u vranë në fabrikën e qeramikës Sanakeram.	30. shtator – 9 tetor 1992.
16	Sokollac	Rreth 44 meshkuj joserbë u ndaluan dhe u vranë në fshatin Novoseoci	22 shtator 1992
17	Teslliq	Në qytetin e Teslliqit, se paku 5 meshkuj joserbë u vranë në godinën e Mbrojtjes Territoriale	qershor 1992.
		Në kampin e Pribiniqit u vranë se paku 7 ose 8 të arrestuar joserbë.	qershor-tetor 1992.
18	Vllasenica	Se paku 6 të arrestuar meshkuj joserbë u vranë në kampin Sushicë	21-23 qershor 1992.
19	Zvornik	Rreth 6 të arrestuar joserbë u vranë në fermën "Ekonomia" në Karakaj.	12-14 maj 1992.
		Së paku 2 të arrestuar joserbë u vranë në godinën Novi Izvor.	maj 1992.
		Se paku 30 të arrestuar joserbë u vranë në Shtëpinë e Kulturës në Çelopek	9 -26 qershor 1992.
		Rreth 110 meshkuj, myslimanë të Bosnjës, u vranë në Shkollën Teknike në Karakaj.	1-3 qershor 1992.
		Rreth 190 të arrestuar joserbë u vranë në therrtoren e Geros	7 qershor 1992.
20	Novi Grad (Sarajevë)	47 meshkuj, myslimanë të Bosnjës, nga Kampi Rajlovc, u vranë afër Srednjes	14 qershor 1992.

LISTA C
OBJEKTE BURGIMI

Nr.	Komuna	Kampi i Burgimit	Data
1	Banja Luka	Ish-kazermat e APJ-së, Mali Llogor (Burgu Ushtarak)	gusht - shtator 1992.
		Burgu i VIZ Tunjice	qershor - nëntor 1992.
		Kampi i Manjaçës	qershor - dhjetor 1992.
2	Bihaq	Traktorski servis, Ripaç (garazhe dhe shtëpi)	korrik -- tetor 1992.
3	Bijellina	Qendra e Burgimit në Batkoviqi	korrik 1992 – qershor 1995.
		Thertorja e re (Nova Klaonica)	prej marsit 1992.
4	Billeqa	Qendra e burgimit e SPB-së	10 qershor – 19 dhjetor 1992.
		Fjetorja e Studentëve (Đacki Dom)	25 qershor –5 tetor 1992.
5	Bosanska Dubica	Godina e SPB-së	qershor – dhjetor 1992.
6	Bosanska Krupa	Shkolla fillore "Petar Koçiq"	prill – shtator 1992.
		Shkolla fillore e Jesenicës	prill –shtator 1992.
7	Bosanski Shamac	Kampi i Cërkinës	maj – tetor 1992.
8	Bosanski Novi	Stacioni i Policisë në Bosanska Kostajnica	maj – korrik 1992.
		Stadiumi i Futbollit në Mllakve	qershor-korrik 1992.
		Stacioni i Zjarrfikësve në Bosanski Novi	korrik – gusht 1992.
9	Bosanski Petrovac	Kampi i Kozillës	maj - gusht 1992.
10	Bërçko	Kazermat e APJ-së në Bërçko	prill - korrik 1992.
		Qendra e Burgimit në Llukë	4 maj–13 korrik 1992.
11	Bratunac	Shkolla "Vuk Karaxhiq"	korrik 1992.
12	Çajniçe	Shtëpia e Gjuetisë në Mostinë	prill, maj 1992.
		Godina e SPB-së në Çajniçe	qershor-korrik 1993.
13	Çellinac	Godina komunale në Çelinac	1 gusht 1992.
14	Doboj	Burgu në Spreça	prill 1992.— shkurt 1993.
		Diskoja e Perçinit (Restoranti "Kod Perço")	maj - gusht 1992.
		Depoja e municionit, Bare	maj 1992.
		Stacioni i SPB-së	maj-gusht 1992.
		Hangarët e APJ-së-së pranë fidanishtës Bosanska) (Kampi i Bosankës)	maj 1992. – qershor 1993.

Nr.	Komuna	Kampi i Burgimit	Data
		Kampi Sesllia	mars - tetor 1993.
15	Donji Vakuf	Kampi i Vërbasprometit.	11 qershor 1992.
		"Shtëpia," një shtëpi përballë godinës së SPB-së.	7 qershor 1992.
		Godina e SPB-së	16 qeshor 1992.
		Depoja e Mbrojtjes Territoriale	16 qershor 1992.
16	Foça	Shkolla e mesme e Foçës	qershor 1992.
		Salla e Sportit "Partizan"	korrik 1992.
		Kampi Livade	prill 1992.
		Burgu "KP Dom"	prill 1992. - tetor 1994.
17	Gacko	Shtëpia e Kulturës në Avtovac.	1 gusht 1992.
		Godina e SPB-së	8 qershor 1992-5 korrik 1992
		Hoteli i Lidhur me elektrocentralin	1 maj 1992
		Hotel "Metohia".	1 maj 1992
18.	Kallinovik	Shkolla Fillore në Kallinovik	korrik 1992 – shtator 1992
		Depoja e barutit midis Jellashicës dhe Jazhiqëve.	5 korrik – 5 gusht 1992.
19	Kluç	Shkolla fillore "Nikolla Maçkic"	maj 1992.
20	Kotor Varosh	Burgu në Kotor Varosh.	qershor – nëntor 1992.
		Punishte sharrash në Kotor Varosh	qershor 1992.
		Stacioni i policisë në Kotor Varosh	maj – shtator 1992.
		Shkolla fillore në Kotor Varosh	gusht – shtator 1992.
21	Nevesinje	Ngrohtorja (Killavci)	qershor – korrik 1992.
22	Prijedor	Kampi i Omarskës	maj - gusht 1992.
		Kampi Keraterm	maj - gusht 1992.
		Miska Gllava	korrik 1992.
		Kazermat e Prijedorit	maj – qershor 1992.
		Kampi i Tërropolës	maj – dhjetor 1992.
23	Përnjavor	Stari Mllin	tetor 1992. - mars 1994.
		Fabrika e këpucëve "Slloga"	maj – dhjetor 1992.
		Ribnjak	nëntor 1992. - janar 1993.

Nr.	Komuna	Kampi i Burgimit	Data
24	Rogatica	Shkolla "Velko Vllahoviq"	maj 1992 – fillim të vitit 1993.
		Rasadnik	qershor 1992. – qershor 1993.
25	Rudo	Bodrumi i shtëpisë së kulturës	qershor 1993. – shkurt 1994.
26	Sanski Most	Fabrika "Krings"	maj - gusht 1992.
		Shkolla "Hasan Kikiq"	maj - qershor 1992.
		Fabrika e betonit "Betonirka"	maj - korrik 1992.
		Dhoma e kaldajës e Hotelit të Vjetër	21 shtator 1995 - 25 shtator 1995.
27	Sokollac	Fabrika e lëkurës "KTK".	korrik - dhjetor 1992.
		Shkolla fillore "Sllavisha Vajner Çiça".	
		Shtëpia e Pllanjës	
		Çavarine.	
28	Teslliq	Pribini } (Posta e vjetër)	qershor - tetor 1992.
		Godina e Mbrojtjes Territoriale	qershor 1992.
		Godina e SPB-së	qershor 1992.
29	Vishegrad	Objekt burgimi në hotelin turistik në Villina Vllas.	1 maj 1992.
		Uzamnica, ish-depoja ushtarake dhe kazeremat	gusht 1992. – tetor 1994.
30	Vllasenica	Objekt i Mbrojtjes Territoriale në Sushicë	qershor 1992.
31	Zvornik	Shtëpia e Kulturës në Çellopek	maj – korrik 1992.
		Shkolla teknike në Karakaj	maj – korrik 1992.
		Qyteti i Zvornikut, godina "Novi Izvor"	prill - shtator 1992.
		Ferma "Ekonomia" në Karakaj	qershor - gusht 1992.

LISTA D
ZHVENDOSJE TË DHUNSHME

Nr.	Komuna	Persona të shpërngulur dhe refugjatë joserbë	Dëbime
<u>NUMRI I PËRGJITHSHËM I TË DËBUARVE – 268.050</u>			
1	Banja Lluca	19.359	Hungaria
2	Bileqa	993	Mali i Zi
3	Bihaq	2.588	
4	Bijelina	13.159	
5	Bosanska Krupa:		
	- <i>Bosanska Krupa</i>	1.439	
	- <i>Buzhim</i>	389	
	- <i>Krupa na Uni</i>	1	
6	Bosanska Dubica	3.310	
7	Bosanska Gradishka	7.516	
8	Bosanski Novi	6.288	
9	Bosanski Petrovac:		
	- <i>Bosanski Petrovac</i>	778	
	- <i>Petrovac</i>	Nuk dihet	
10	Bosanski Shamac:		Kroacia
	- <i>Shamac</i>	1.563	
	- <i>Domalevac-Shamac</i>	217	
11	Bratunac	8.048	
12	Bërçko:		
	- <i>Bërçko</i>	14.607	
	- <i>Ravne / Rahiq</i>	1.532	
13	Çajnice	2.214	
14	Çelinac	608	
15	Doboj:		
	- <i>Doboj</i>	18.569	
	- <i>Doboj Istok</i>	405	
	- <i>Doboj Jug</i>	310	
16	Donji Vakuf	1.729	
17	Foça:		
	- <i>Foça / Sërbinje</i>	8.258	
	- <i>Foça FBiH</i>	1.039	
18	Gacko	1.899	Maqedonia
19	Gorazhde:		
	- <i>Gorazhde FBiH</i>	2.563	
	- <i>Sërpsko Gorazhde</i>	1.834	
20	Kallinovik	612	
21	Kluç:		
	- <i>Kluç</i>	3.852	
	- <i>Kluç / Ribnik</i>	26	
22	Kotor Varosh	6.870	
23	Nevesinje	1.483	
24	Prijedor	20.256	
25	Përnjavor	3.490	

Nr.	Komuna	Persona të shpërngulur dhe refugjatë joserbë	Dëbime
26	Rogatica	6.650	
27	Rudo	1.614	Maqedonia
28	Sanski Most:		
	- <i>Sanski Most</i>	6.257	
	- <i>Srpski Sanski Most</i>	221	
29	Srebrenica	25.000	
30	Shekoviqi	162	
31	Shipovo	1.427	
32	Sokollac	2.670	
33	Teslliq	7.789	
34	Trebinje:		
	- <i>Trebinje</i>	3.116	
	- <i>Ravno</i>	201	
35	Vishegrad	6.690	
36	Vllasenica	6.942	
37	Zvornik:		Hungaria, Austria
	- <i>Zvornik</i>	15.436	
	- <i>Sapna</i>	1.335	
QYTETI I SARAJEVËS			
38	Illixha:		
	- <i>Illixha</i>	218	
	- <i>Sërpska Illixha</i>	60	
39	Novi Grad i Sarajevës	9.008	
40	Sarajevë e Re:		
	- <i>Sarajevë e Re</i>	7.097	
	- <i>Sarajeva e Re Serbe</i>	4	
41	Vogoshqa	2.099	
SARAJEVA E GJERË			
42	Haxhiqi	1.390	
43	Illijash	1.889	
44	Palle:		
	- <i>Palle</i>	1.697	
	- <i>Palle FbiH</i>	115	
45	Tërnovë:		
	- <i>Tërnovë, Republika Srpska</i>	744	
	- <i>Tërnovë, FbiH</i>	415	

**LISTA E
RASTE TË QITJEVE ME SNAJPERËVE NË SARAJEVË**

Nr.	Incident	Data
1	Fadila ZGODIQI, grua 52 vjeçe, u godit me plumb dhe u plagos në ije duke marrë bukë afër Rrugës Darovallaca Kërvi, tash Rruga Kollodvorska, në lagjen e Sarajevës së Re.	7 nëntor 92.
2	Anisa PITA, vajzë 3 vjeçe, u godit me plumb dhe u plagos në këmbën e djathtë ndërsa po hiqte këpucët në hajatin e shtëpisë së vet në Rrugën Zhagriqi në lagjen Shirokaça të Sarajevës.	13 dhjetor 1992.
3	Viktima, një vajzë nëntëvjeçare, u godit me plumb dhe u plagos në shpinë ndërsa luante në kopshtin e përparmë të shtëpisë në lagjen Sedrenik të Sarajevës.	17 prill 1993.
4	Muhamed HAZNEDAREVIQI, 52 vjeç, u godit me plumb dhe u plagos në shpinë dhe në gjoks ndërsa po punonte në një kopësht perimesh në Slatinski Put 5, tani Slatinski Put 13, Kobilja Glava, në veri të Sarajevës.	25 qershor 1993.
5	Almasa KONJHODZHIQI, grua 56 vjeçe, u vra me armë zjarri afër kryqëzimit të Rrugëve Gjyre Gjakoviqa dhe Kranjçeviqa, tani Alipashina dhe Kranjçeviqa, duke ecur me familjen.	27 qershor 1993.
6	Munira ZAMETICA, grua 48 vjeçe, u vra me armë zjarri duke marrë ujë nga Lumi i Dobrinjes në lagjen Dobrina II dhe III	11 korrik 1993.
7	Hajrija DIZDAREVIQI, grua 66 vjeçe, u vra ndërsa falej në banesën e vet në Kranjçeviqa 11/5, tani Rruga Xhamijska,	17 korrik 1993. ose rreth kësaj date
8	Mejra JUSOVIQI, grua 45 vjeçe, u godit me plumb dhe u plagos ndërsa tërhiqte një barrë drush drejt shtëpisë së vet në Rasadnjak, në lagjen e Sedrenikut, Sarajevë.	24 korrik 1993
9	Vildana KAPUR, 21 vjeçe, u godit me plumb dhe u plagos në këmbë duke çuar ujë në shtëpi në Rrugën Stara Çesta, lagjen e Hotonjit.	5 gusht 1993.
10	Nafa TARIQI, 35 vjeçe dhe vajza e saj Elma TARIQI, 8 vjeçe, u goditën prej një plumbi të vetëm duke ecur bashkë në Rrugën Ivana Kërndela në qendrën e Sarajevës. Plumbi plagosi nënën në kofshën e majtë dhe e plagosi vajzën në dorë dhe në bark.	3 shtator 1993.
11	Shaqir BOSNIQI, burrë 56 vjeç, u vra me armë zjarri ndërsa mblidhte dru matanë rrugës përballë Rezervuarit Hambina Carina dhe pranë Rrugës Zelengorska, tani Rruga Hambina Carina, në Shirokaça, Skënderija.	7 shtator 1993.
12	Edina TËRTO, grua 25 vjeçe, u vra me armë zjarri duke ecur pranë Rrugës Ivan Kërndeljes 6, tani Azize Shaqerbegoviqi 12, Sarajevë.	26 shtator 1993.
13	Faruk KADRIQI, djalë 16 vjeç, u godit me plumb dhe u plagos në qafe ndërsa udhëtonte si pasagjer në kamionin e të atit gjatë Rrugës Ante BABIQI, në anën perëndimore të Sarajevës.	4 tetor 1993.
14	Edin RAMOVIQI, 29 vjeç, u godit me plumb dhe u plagos në krahun e sipërm të majtë ndërsa ecte në Rrugën Stara Çesta, në lagjen Bare të Sarajevës.	7 tetor 1993.

Nr.	Incident	Data
15	Ramiz VELIQI dhe Millan RISTIQI, respektivisht 50 dhe 56 vjeç, u plagosën prej një breshëri plumbash ndërsa pastronin Rrugën Braçe Ribara, tani Rruga Porodice Ribar nga plehrat, në lagjen Hrasno të Sarajevës.	2 nëntor 1993.
16	Ramiza KUNDO, 38 vjeçe, u godit me plumb dhe u plagos në këmbën e majtë ndërsa ajo dhe një grua tjetër po ktheheshin prej një pusi, duke mbajtur kova me ujë, afër Rrugës Brishko Bërdo, tani Rruga Bulbulistan, në anën perëndimore të Sarajevës.	2 nëntor 1993.
17	Fatima OSMANOVIQI, 44 vjeçe, u godit me plumb dhe u plagos në anën e djathtë të fytyrës ndërsa mbante ujë në Rrugën Brijeshko Bërdo. tani Rruga Bulbulistan, në anën perëndimore të Sarajevës.	13 nëntor 1993.
18	Sanija XHEVLLANI, 32 vjeçe, u godit me plumb dhe u plagos duke kaluar me biçikletë një urë në Rrugën Nikolla Demonja, Dobrinja.	6 janar 1994.
19	Edin HUSOVIQI, 17 vjeç, u godit me plumb dhe u plagos duke qëndruar përballë një picerie në Rrugën e Brigadës Proletare të 6-të, tani Bulevard Mesha Selimoviq	10 janar 1994.
20	Hetema MUKANOVIQI, 38 vjeçe, u vra prej një plumbi në banesën e vet në katin e parë të Oballës 27 Korriku 89/I, tani Aleja Lipa 64, në lagjen Hrasno të Sarajevës. Në atë kohë ajo po pinte kafe me burrin dhe me fqinjët, nën dritën e qiriut.	11 janar 1994.
21	Ivan FRANJIQI, 63 vjeç, po ecte me dy të tjerë në Rrugën Ante Babiq në Vojničko Pole, në anën perëndimore të Sarajevës. Ai u godit dhe u plagos në bark, ndërsa Augustin VUÇIQI, një nga shokët e tij, u godit dhe më vonë vdiq nga plagët.	13 mars 1994.
22	Sadeta PLLIVACI, 53 vjeçe dhe Hajra HAFIZIVIQI, 62 vjeçe, u goitën dhe u plagosen në këmbë duke udhëtuar në një autobus të stërmbushur afër kryqëzimit të Rrugës Nikole Demonje dhe Bulevard KAÇKJ, tani Nikole Demonje dhe Bulevard Branioca Dobrinja, në Dobrinja.	25 maj 1994.
23	Fatima SALÇINI, 44 vjeçe, u godit me plumb dhe u plagos në dorë ndërsa ecte me vjehrrin në Rrugën Ivo Andriqi në lagjen Momillo të Sarajevës.	13 qershor 1994.
24	Sanela MURATOVIQI, 16 vjeçe, u godit me plumb dhe u plagos në supin e djathtë, duke ecur me një shoqe në Rrugën Gjyre Jakshiq, tani Adija Mullabegoviq, në anën perëndimore të Sarajevës.	26 qershor 1994.
25	Jasmina KUÇINARI, një grua shtatzënë 31-vjeçare, dhe i biri Damir KUÇINARI, 4 vjeç, u plagosën lehtë në këmbë prej një plumbi i cili depërtoi në tramvajin e stërmbushur në të cilin po udhëtonin. Tramvaji po shkonte në drejtimin perëndimor në Rrugën Zmaja od Bosne drejt Alipashino Pole. Mensur JUSIQI, 36 vjeç, u plagos lehtë në këmbë dhe Belma SUKIQI (Likiq), 23 vjeçe, u plagos në sqetullën e majtë në të njëjtin sulm. Tramvaji ishte afër hotelit "Holday Inn" në kohën e ngjarjes.	6-10 korrik 1994.

Nr.	Incident	Data
26	Rashid XHONKO, 67 vjeç, u godit me plumb dhe u plagos në shpinë ndërsa shikonte televizorin në banesën e tij në Rrugën Milanka Vitomira, tani Rruga Senada Mandiqa Dende 5 në Vojničko Pole, në perëndim të Sarajevës.	17 korrik 1994.
27	Seid SOLAKU, 13 vjeç, u godit me plumb dhe u plagos në bark duke shikuar vitrinat me nënën dhe motrën e tij në Rrugën Milenka Cvitkoviqa, tani Ferde Hauptmana, në lagjen Cengiq Vila të Sarajevës.	22 korrik 1994.
28	Alma QUTUNA, 43 vjeçe, u plagos në kofshën e djathtë duke udhëtuar me tramvaj në Rrugën Zmaj od Bosne në Sarajevë.	8 tetor 1994.
29	Adnan KASAPOVIQI, 16 vjeç, u godit me plumb në krahëror dhe u vra duke ecur në një rrugicë pranë Rrugës Gjorgje Andrijeviqa Kuna.	24 tetor 1994.
30	Fata GUTA, grua 59 vjeçe, u godit me plumb dhe u plagos në dorë ndërsa dilte me bidon për të marrë ujë nga çezma Moshčanica në Gazin Han, në lindje të Sarajevës.	8 nëntor 1994.
31	Sanja SMJEÇANINI, grua shtatzënë 28 vjeçare, u godit me plumb dhe u plagos duke udhëtuar me të shoqin dhe kunaten në një makinë në Rrugën Zmaj od Bosne.	9 nëntor 1994.
32	Xhenana SOKOLOVIQI, 31 vjeçe dhe i biri Nermin DIVOVIQI, 7 vjeç, u qëlluan duke ecur në Rrugën Zmaj od Bosne. Zonja SOKOLOVIQ u plagos me një plumb në bark. Plumbi kaloi nëpër trupin e saj dhe e goditi të birin në kokë, duke e vrarë. Ata po shkonin në shtëpi nga Hrasno, ku kishin qenë një ditë më parë për të marrë dru zjarri.	18 nëntor 1994.
33	Hajrudin HAMIDIQI, 52 vjeç, u plagos në krah dhe në fytyrë ndërsa u qëllua tramvaji të cilin ai po e ngiste në drejtim perëndimor në Rrugën Zmaj od Bosne.	21 nëntor 1994.
34	Sanella DEDOVIQI, vajzë 12 vjeçe, u plagos në nyjën e këmbës së majtë duke shkuar në shkollë. Kjo ngjarje ndodhi në udhëkryqin e Rrugës së Sedrenikut dhe Rrugës Rexhepa Gorushanoviqa, në lagjen veriperëndimor të Sarajevës.	22 nëntor 1994.
35	Hafiza KARAÇIQI, 31 vjeçe dhe Sabina SHABANIQI, 26 vjeçe, u plagosën të dy në supin e djathtë ndërsa tramvaji me të cilin udhëtonin u qëllua në Rrugën Zmaj od Bosne, midis Shkollës Teknike dhe Kazermës "Marshall Tito"	23 nëntor 94.
36	Lejla BAJRAMOVIQI, 24 vjeçe, po rrinte në banesën e një miku në Rrugën Franca Lehara, afër qendrës së Sarajevës, kur u godit në kokë dhe u vra. Plumbi hyri nëpër dritaren e banesës.	8 dhjetor 1994.
37	Dervisha SELMANOVIQI, 49 vjeçe, u godit me plumb dhe u plagos në gjurin e djathtë ndërsa mblidhte dru zjarri në oborrin e prapmë	10 dhjetor 1994.
38	Malkan PLEHO, 62 vjeç, u godit me plumb dhe u plagos në pjesën e poshtme të këmbës së djathtë duke ngjitur shkallët e hyrjes në shtëpinë së tij në Sedrenik, në Sarajevën perëndimore.	11 dhjetor 1994.

Nr.	Incident	Data
39	Halid DEMIROVIQI, 62 vjeç, u godit me plumb dhe u plagos në thembrën e djathtë ndërsa mblidhte dru zjarri në Pashino Bërdo, në Sarajevën verilindore.	13 dhjetor 1994.
40	Senad KESMERI, 23 vjeç, Alma ÇEHAGIQI, 19 vjeçe, Alia HOLANI, 55 vjeç dhe të tjerë u goditën me plumb dhe u plagosën duke udhëtuar në një tramvaj në Rrugën Zmaj od Bosne. Tramvaji po udhëtonte në drejtim perëndimor dhe në atë kohë gjendej afër Kazermave Tito	27 shkurt 1995.
41	Azem AGOVIQI, 46 vjeç, dhe Allen GIÇEVIQI, 33 vjeç, u goditën me plumb dhe u plagosën duke udhëtuar në një tramvaj në Rrugën Zmaj od Bosne. Tramvaj gjendej në atë kohë afër Hotelit "Holiday Inn."	3 mars 1995.
42	Tarik ZHUNIQI, 14 vjeç, u plagos në dorë duke u kthyer më këmbë nga shkolla në Rrugën e Sedrenikut, në Sarajevën perëndimore. Kur u godit, ai kishte nga prapa një panel mbrojtës, 100 metra prej shtëpisë.	6 mars 1995.
43	Vahid BALTA, 52 vjeç, u godit me plumb në nyjën e këmbës ndërsa ecte me të shoqen në Rrugën e Sedrenikut, në Sarajevën verilindore.	6 mars 1995.
44	Një i ri u godit në ijën e majtë dhe u vra ndërsa po kalonte udhëkryqin e rrugës Nikolle Demonje dhe Bularvardit KAÇKJ në lagjen Dobrinje.	18 mars 1995.
45	Shemsa COVËRKU, grua 27 vjeçe, u godit me plumb dhe u plagos në bark ndërsa shëtiste në Rrugën Jospia Krasha, Novi Grad, duke mbajtur djalin e vet për dore.	3 maj 1995.
46	Një mashkull u godit me plumb dhe u vra në Rrugën Dinarska, Hrasno Bërdo.	13 maj 1995.
47	Durgut ÇOBIQI, 80 vjeç, u godit me plumb dhe u plagos në sup ndërsa hapte derën e ballkonit të banesës së tij në Rrugën Kunovska 4/I, Dobrinja	25 maj 1995.

LISTA F
RASTE TË GRANATIMIT NË SARAJEVË

Nr.	Incident	Data
1	Dy predha u lëshuan kundër një turme prej rreth 200 njerëzish të cilët po shikonin dhe po luanin futboll në një vend parkimi të rrethuar në tre anë nga apartamente banimi dhe në anën e katërt nga Rruga e Llukavicës në Donbrinja 3B, një lagje me banesa. Së paku 12 vetë, duke përfshirë tre fëmijë, u vranë dhe se paku 70 njerëz, duke përfshirë 10 fëmijë, u plagosën. Zjarri erdhi prej territorit në duart e UBS-së, pak a shumë në lindje-juglindje.	1 qershor 1993.
2	Një predhë mortaje 82 mm u lëshua kundër rreth 100 civilësh të cilët prisnin që të merrnin ujë prej një pompe të përbashkët në oborrin e një shtëpie në Rrugën Hakije Turaj liqa 39 (më parë Rruga Aleja Branka Buliqa dhe pastaj Spasenije Cane Baboviq) në Dobrinja, një lagje me banesa. Së paku 12 vetë u vranë dhe 14 u plagosën. Zjarri erdhi prej territorit në duart e UBS-së, pak a shumë në perëndim-veriperëndim.	12 shtator 1993.
3	Tre predha mortaje goditën një pjesë të Alipashino Poles, e para në një park prapa banesave në Rrugën Geteova (ish-Centinjka) dhe në 4 Rruga Bosanska, ku fëmijë luanin. E dyta dhe e treta ranë para banesave dhe vranë gjashtë fëmijë nën moshën 15 dhe plagosën një të rritur dhe katër fëmijë. Zjarri erdhi prej territorit në duart e UBS-së, pak a shumë në perëndim.	22 janar 1994.
4	Një breshër prej tri predhash mortaje 120 mm goditi civilë në lagje të banuara në Dobrinjë. E para goditi murin e përparmë të një godine banesash në Rrugën Oslobodillaca Sarajeva, duke goditur njerëz që po shpërndanin dhe merrnin ndihmë humanitare dhe fëmijë që ndiqnin mësimet fetare. E dyta dhe e treta goditën njerëz që shitnin dhe blinin në një treg në një fushë të hapur prapa banesave në Rrugën Mihajla Pupina dhe Rrugën Oslobodillaca Sarajeva. Tetë vetë, duke përfshirë një fëmijë nën moshën 15, u vranë dhe se paku 18 vetë duke përfshirë 2 fëmijë u plagosën. Zjarri erdhi prej territorit në duart e UBS-së, pak a shumë në lindje..	4 shkurt 1994.
5	Një predhë mortaje 120 mm goditi një treg të stërmbushur nën qiellin e hapur, të quajtur "Markalle", i cili gjendej në një lagje civile të Qytetit të Vjetër të Sarajevës, duke vranë 66 vetë dhe duke plagosur mbi 140 vetë, duke përfshirë tre fëmijë nën moshën 15. Zjarri erdhi prej territorit në duart e UBS-së, pak a shumë në veri-verilindje..	5 shkurt 1994.
6	Një granatë predhë 120 mm goditi një grup civilësh në një qëndrim autobusi në rrugën e Igmanit. Një person u vra dhe 15 u plagosën. Zjarri erdhi prej territorit në duart e UBS-së në Vojkoviqi..	30 tetor 1994.
7	Tri predha mortaje goditën Rrugën Livanjska, një rrugë me banesa civile. Dy persona u vranë dhe gjashtë u plagosën. Zjarri erdhi prej drejtimit të Polines, territor në duart e UBS-së.	8 nëntor 1994.
8	Një predhë mortaje 120 mm goditi Rrugën Partizanska Nr. 18 në Hrasnicë. Dy fëmijë të moshës tetë dhe dy vjeç u vranë dhe tre të rritur u plagosën.	17 nëntor 1994.
9	Një predhë mortaje 82 mm goditi një vend afër një banese civile, duke vranë një plak dhe duke plagosur gruan e tij plakë. Zjarri erdhi prej territorit në duart e UBS-së.	12 dhjetor 1994.
10	Dy predha 76 mm, njëra pas tjetres, goditën një treg plaçkash në lagjen tregtare të vjetër të Bashçarshisë në Qytetin e Vjetër. Dy persona u vranë dhe shtatë u plagosën. Zjarri erdhi nga pozicionet e UBS-së në Trebeviq.	22 dhjetor 1994.
11	Një bombë aeroplani e përshtatur goditi një lagje banesash në Hrasnicë rrëzë Malit të Igmanit dhe duke shkatërruar një shtëpi dhe duke dëmtuar 11 shtëpi	7 prill 1995.

Nr.	Incident	Data
	të tjera. Një person u vra dhe tri u plagosën. Zjarri erdhi prej Illoxhës, në territorin e UBS-së.	
12	Një predhë mortaje 60 mm goditi një sipërfaqe me beton afër stacionit hekurudhor të Sarajevës. Shtatë persona u plagosën. Zjarri erdhi nga Zllatishta në territorin e UBS-së.	12 prill 1995.
13	Një raketë goditi asfaltin e Rrugës Safeta Zajke rreth orës 0945 dhe shpërtheu duke vranë dy persona dhe duke plagosur pesë. Raketa erdhi nga juglindja, drejtimi i Llukavicës.	24 maj 1995.
14	Një bombë ajrore e modifikuar goditi Rrugën Majdanska, pa numër. Dy civilë u vranë dhe gjashtë u plagosën. Zjarri erdhi nga territori i UBS-së në Pavllovac në juglindje.	24 maj 1995.
15	Një bombë ajrore e modifikuar goditi një godinë afër banesave në Rrugën Safeta Hoxhiq, duke shkatërruar tre kate të sipërme të një godine apartamentesh. Pas këtij shpërthimi, në po këtë rrethinë goditën disa predha artilerie. Disa ndërtesa u dëmtuan rëndë. Dy persona u plagosën rëndë dhe 15 persona u plagosën lehtë. Zjarri u përcaktua se kishte ardhur nga territori i UBS-së në perëndim-jugperëndim.	26 maj 1995.
16	Rreth orës 1000, një bombë aeroplani e modifikuar u lëshua prej veriperëndimit. Bomba e goditi ndërtesën e Qendrës Mjekësore Universitare dhe Degën e Onkologjisë në Rrugën Dositejeva 4-a dhe shpërtheu. Dëmtimet ishin të mëdha dhe tre persona u plagosën lehtë.	16 qershor 1995.
17	Rreth orës 1520, një bombë aeroplani e modifikuar, me gjasë e lëshuar nga Llukavica, shpërtheu pranë Tërg Medjunarodnog Prijateljstva Nr. 10, duke plagosur lehtë shtatë persona dhe duke dëmtuar dukshëm ndërtesat fqinje.	16 qershor 1995.
18	Në orën 1720, një bombë aeroplani e modifikuar u lëshua nga veriperëndimi. Ajo shpërtheu në shtëpinë në Rrugën Çobanija Nr. 7. Dy persona u plagosën.	16 qershor 1995.
19	Një predhë mortaje 120 mm goditi një rresht prej rreth 50-70 civilësh, të cilët po pritnin shpërndarjen e ujit në Rrugën Marka Oreshkoviqa në Dobrinja. Shtatë persona u vranë dhe dymbëdhjetë u plagosën. Zjarri erdhi nga Nexhariqi në territorin e UBS-së.	18 qershor 1995.
20	Një predhë u lëshua në Bulevardin Meshe Selimoviqa, me gjasë nga rrethina e Rajlovacit. Nuk pati viktima.	29 qershor 1995.
21	Rreth orës 1330, një raketë me përplasje të fuqishme goditi vendin pranë shtëpisë në Radenko Abazoviqa Nr. 5. U lëshua nga pjesa perëndimore e qytetit (Illoxha-Rajlovac). Nuk pati viktima.	1 korrik 1995.
22	Rreth orës 2130, një predhë rakete me mbushje tronditëse shpërtheu në Rrugën Bunički Potok. U plagosën 13 persona. Predha erdhi nga Illoxha.	1 korrik 1995.
23	Një predhë mortaje 120 mm. goditi afër një banese në Vërbanjusha 95 (një lagje banimi). U vra një djalë.	19 korrik 1995.
24	Një raketë me mbushje tronditëse, duke ardhur nga drejtimi i Illoxhës/Blazhuj, goditi një shtëpi në Rrugën Sokoloviqi Bjellashnička 54. Dy persona u vranë dhe 11 u plagosën lehtë.	23 korrik 1995.
25	Një mekanizëm shpërthyes i modifikuar shpërtheu në shkallën midis katit të dytë dhe katit të tretës të ndërtesës së BITAS-it në Rrugën Zmaja od Bosne 64. Një person vdiq dhe një person tjetër u plagos lehtë. Zjarri erdhi nga territori i UBS-së në jugperëndim.	22 gusht 1995.
26	Një predhë mortaje 120 mm goditi Rrugën Mulla-Mustafe te hyrja në tregun e qytetit. U vranë 43 persona dhe u plagosën 75. Zjarri erdhi nga Trebeviqi në territorin e UBS-së.	28 gusht 1995.

Page: 13

[KB1] Numrat e të vrarëve dhe të plagosurve, të ndaluarbe dhe të shpërngulurve të dhënë në këtë Tabelë dhe në të gjitha tabelat e tjera të bashkëngjitura kësaj aktakuze janë vlerësimet më të sakta që mund të japë